



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë
Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike”
“Universiteti EPOKA”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Asoc. Olimpjon Shurdi

Olimpjon Shurdi 

Prof. Asoc. Elson Agastra

Elson Agastra



Shtator 2020

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit: Bsc në "Inxhinieri Kompjuterike"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti "EPOKA"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 281, Datë 12.03.2008 me kohëzgjatje akademike katër vite, 240 Kredite ECTS
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS Nr. 213, datë 25.05.2012, me kohëzgjatje akademike tre vite, 180 Kredite ECTS
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.565, datë 22.11.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	Vendim i Bordit të Akreditimit, Nr. 78, datë 21.09.2017
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Anglisht
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	JO
13.1	• Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	JO
13.2	• Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	JO
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	15 PAE dhe 5 PAK (75% / 25%)
16	Numri i studentëve (për tre vite):	271
17	Komente / të tjera:	-

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti "EPOKA" është një institucion privat i arsimit të lartë i krijuar në bazë të vendimit Nr. 281, datë 12.03.2008, të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Në të njëjtën kohë, bazuar në dispozitat e legjislacionit shqiptar të arsimit të lartë, në zbatim të Urdhrit Nr. 260, datë 07.06.2011, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Shqipërisë, Universitetit "EPOKA" i është dhënë akreditimi institucional për herë të parë. Universiteti "EPOKA" ka fituar akreditim periodik institucional bazuar në vendimin Nr. 92, datë 20.10.2017 të Bordit të Akreditimit.

Për të siguruar respektimin e plotë të dispozitave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statuti i ri është miratuar nga organet kompetente të Universitetit "EPOKA" në vitin 2016 dhe është aprovuar bazuar në Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 114, Datë 31.03.2017. Misioni i Universitetit "EPOKA" është që të jetë një institucion inovativ dhe me ndikim mësimor dhe kërkimor, duke shërbyer për vlerat themelore njerëzore përmes prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të njohurive në një nivel ndërkombëtar, si dhe të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale.

Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike të Universitetit "EPOKA" ofrohet nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, pjesë integrale e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë.

Në përputhje me Legjislacionin e Arsimit të Lartë në fuqi, programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike u licencua Vendimi i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 281, Datë 12.03.2008 me kohëzgjatje normale akademike katër vite, 240 Kredite ECTS. Me Urdhër të MASH, Nr. 260, Datë 07.06.2011, ky program akreditohet.

Në bazë të Urdhrit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 213, datë 25.05.2012, programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, u riorganizua në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, me një kohëzgjatje normale të studimeve të tre (3) viteve akademike, 180 Kredite ECTS.

Me Vendim Nr. 78, datë 21.09.2017 të Bordit të Akreditimit Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike mori akreditimin e tij të fundit periodik, me afat 3 vite akademike (me vlefshmëri deri më 30.09.2020). Ky vlerësim është në kuadër të akreditimit periodik të rradhës.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I MËPARSHËM

Analiza e Përbushjes së Rekomandimeve të dhëna nga Bordi i Akreditimit në Vendimin Nr. 78, datë 21.09.2017 të Akreditimit të mëparshëm të programit të studimit dhe gjykimin për përbushjen e 4 rekomandimeve:

Rekomandimet e Bordit të Akreditimit:

- a) Të rekrutohet stafi i ri akademik me qëllim uljen e ngarkesës mësimore për stafin akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi;
- b) Të garantohet përcaktimi i titullarëve me kualifikimin e duhur akademik sipas standardeve të kërkuara për të gjitha lëndët e këtij programi;
- c) Të përfshihen në syllabuset e lëndëve njohuritë paraprake të nevojshme për studentët për ndjekjen e lëndës;
- d) Të mundësohen kurse afatshkurtëra të gjuhës angleze teknike të fushës për përvetësimin e dijeve në kuadër të këtij programi.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm GVJ, duke i mbështetur në Dosjen e Vetëvlerësimit DVV [dok. Action Plan_Fulfillment of Recommendation from previous accreditation], Raporti i Vlerësimit të Brendshëm RVB dhe vizitën në institucion shpreh mendimin se institucioni i ka përbushur rekomandimet e Bordit të Akreditimit si më poshtë:

- **Rekomandimi 1.** Të rekrutohet stafi i ri akademik me qëllim uljen e ngarkesës mësimore për stafin akademik aktual të angazhuar në këtë program studimi;

GVJ: Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur në dosjen DVV, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në tre vitet e fundit akademike është shtuar me staf të ri efektiv nga 11 PAE në vitin akademik 2017-2018; 14 PAE në 2018-2019 dhe 15 PAE në vitin e fundit akademik. Ngarkesa mësimore në këtë program studimi garantohet në masën më të madhe (rreth 80 %) nga stafi efektiv (të paktën në vitin e fundit akademik). Për programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, stafi akademik efektiv ka një ngarkesë deri diku të balancuar vjetore. Gjithsesi, për një pjesë të stafit efektiv të departamentit përgjegjës për programin e studimit vërehet një ngarkesë vjetore deri diku e lartë edhe nga angazhimi në programe të tjera studimi të njesisë kryesore. Në tërësi, gjykojmë se ky rekomandim është përbushur **plotësisht**.

- **Rekomandimi 2.** Të garantohet përcaktimi i titullarëve me kualifikimin e duhur akademik sipas standardeve të kërkuara për të gjitha lëndët e këtij programi;

GVJ: Duke analizuar syllabuset e programit të studimit të paraqitur në dosjen DVV vërehet se jo të gjitha lëndët kanë titullar personel akademik me titullin e kërkuar nga dispozitat ligjore në fuqi [Neni 59, pika 3 e ligjit 80/2015]. Pjesa më madhe e lëndëve të programit të analizuar kanë titullar personel akademik të kategorisë “Profesor”, por jo të gjitha. Një pjesë e lëndëve kanë titullar personel akademik me gradën shkencore “Doktor”, dhe një pjesë e vogël kanë titullar me kualifikimin “Master i Shkencave”. Personeli akademik me titullin akademik “Profesor i Asociuar” ose “Profesor” si dhe/ose me gradën shkencore “Doktor” mund të jenë titullar të lëndëve, ndërsa personeli akademik me kualifikimin Master i Shkencave mund të jetë lektor/asistent lektor i lëndës por jo titullar i saj. Ky rekomandim rezulton i plotësuar **pjesërisht**.

Megjithatë GVJ mendon se në plotësimin e syllabuseve, për pjesën e titullarit vihet re një ngatërresë e termit “titullar lënde” me “pedagog të lëndës”. Edhe sipas VKM 41 datë 24.01.2018,

në syllabus duhet të paraqitet titullari / pedagogu i lëndës dhe syllabusi të jetë i nënshkruar prej titullarit/pedagogut.

Në aktet ligjore në fuqi deri në ditën e përpilimit të këtij dokumenti, nuk ka një përkufizim të saktë të termit “titullar të lëndës”.

Kjo vihet re, edhe në nenin 59 të ligjit 80/2015 për “Kategoritë e personelit akademik” ku: [...Në kategorinë “Profesorë” përfshihen anëtarët e personelit akademik, **titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë kërkimore-shkencore. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie mbajnë titujt akademikë “Profesor” ose “Profesor i asociuar” ...]**

Ky përkufizim është trashëguar nga ligji 9741 (jo më në fuqi) datë 21.05.2007 për arsimin e lartë, ku në nenin 47 për “Personeli akademik dhe titujt akademik” shprehet [...Në kategorinë “Profesorë” janë anëtarët e personelit akademik, **titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor. Anëtarët e personelit akademik të kësaj kategorie kanë gradën shkencore “Doktor” dhe titujt akademikë: “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus”, “Akademik i asociuar” dhe “Akademik” ...].**

Për sa më sipër, qartazi që të dy ligjet e arsimit të lartë, ai aktualisht në fuqi dhe ai i shfuqizuar, kishin të njëjtin përkufizim të kategorisë “Profesor” si dhe të “titullarit të lëndës”.

Megjithatë, nëse i referohemi VKM 467, datë 18.07.2007 (në fuqi deri më 02.03.2018 e cila shfuqizohet nga VKM 112, datë 23.02.2018 që botohet në fletoren zyrtare më 02.03.2018), për “Përcaktimin e Kritereve dhe të Procedurave për Kualifikimin, Shkencor e Pedagogjik, të Personelit Akademik”, në kriteret për dhënien e titullit akademik “Profesor i Asociuar” (neni 2.2 pika ç) është: [... ç) Kanë qenë **titullarë, së paku, të një lënde a moduli për më shumë se dy vite akademike dhe kanë përgatitur materiale mësimore, në formë skriptesh, cikël leksionesh, udhëzues praktikash ose ushtrimesh ...].** Pra sipas leximit të këtij kriteri, edhe pse në të dy ligjet përkatës të arsimit të lartë nuk ishte e përkufizuar, personeli akademik me gradën shkencore “Doktor” përpara se të marri titullin akademik “**Profesor i Asociuar**” duhet të ketë qenë **titullar** i së paku një lënde apo moduli.

Pra nga sa më sipër interpretohet se, të paktën deri më datë 02.03.2018, titullar lënde mund të jesh edhe me gradën shkencore “Doktor” pa pasur titujt akademik “Profesor i Asociuar” apo “Profesor”. Pra deri 3 vite mbas hyrjes në fuqi të ligjit 80/2015, titullar lënde mund të jesh edhe me vetëm gradën shkencore “Doktor”.

Megjithatë në legjislacionin në fuqi, në dijeninë tonë, nuk ka një përkufizim të qartë mbi detyrat e titullarit të lëndës dhe peshën që duhet të ketë në mbarëvajtjen e lëndës/ve ku është titullar.

- **Rekomandimi i 3.** Të përfshihen në syllabuset e lëndëve njohuritë paraprake të nevojshme për studentët për ndjekjen e lëndës;

GVJ: Nga analizimi i dokumentacionit të paraqitur në dosjen DVV, në të gjithë syllabuset renditen edhe lëndët/njohuritë që një student duhet të ketë paraprakisht të përvetësuar që të ndjekë dhe përvetësojë njohuritë e lëndës. Syllabuset kanë të gjitha elementet të cilat tregojnë qartë lidhjen me lëndët dhe modulet e programit të studimit, njohuritë bazë të nevojshme për zhvillimin e lëndës, objektivat dhe arritjet. Syllabuset janë të azhornuara sipas kërkesave të VKM 41 dt. 24.01.2018 dhe mbështeten në literaturën e 5 viteve të fundit.

Gjithsesi, kërkesa e paraqitur këtu në rekomandimin 3 (viti 2017), nuk është më e detyrueshme pasi nuk është pjesë e kërkesave të VKM 41, datë 24.01.2018.

Në të dy këndvështrimet, ky rekomandim rezulton i përmbushur **plotësisht**.

- **Rekomandimi i 4.** Të mundësohen kurse afatshkurtëra të gjuhës angleze teknike të fushës për përvetësimin e dijeve në kuadër të këtij programi:

GVJ: Në planin mësimor, që në semestrin parë të vitit të parë është parashikuar një lëndë për përvetësimin e gjuhës angleze teknike, “*Development of Reading and Writing Skills in English I*”. Kjo lëndë pasohet në semestrin e dytë të vitit të parë nga lënda “*Development of Reading and Writing Skills in English II*” me qëllim rritjen nivelit të përvetësimit të njohurive në gjuhën angleze. Bazuar në plan-programin e këtyre dy lëndëve, si dhe në kriteret hyrëse/pranuese të studentëve në këtë program studimi (njohja paraprake e gjuhës angleze të paktën në nivel B1), e konsiderojmë **të përmbushur** këtë rekomandim.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përbërja e GVJ

Prof. Asoc. Olimpjon Shurdi

Prof. Asoc. Elson Agastra

Parimet e Punës së GVJ

Burimi parësor i informacionit për grupin e punës ishte Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i hartuar në Shkurt 2020 nga vetë institucioni. Raporti siguron një pamje të detajuar të sistemeve dhe mekanizmave që ka ngritur Universiteti EPOKA për të përmbushur objektivat e veta si dhe për të arritur efektivitetin e procedurave të tij për menaxhimin e cilësisë dhe standardeve. Universiteti EPOKA, po ashtu, vuri në dispozicion të GVJ një numër dokumentesh shtesë në plotësim e përditësim të elementëve të paraqitur të RVB.

Për realizimin e këtij vlerësimi, GVJ u mbështet kryesisht tek kërkesat e parashkruara nga Ligji Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr. 531, datë 11.9.2018 “Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”, VKM Nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programit të studimit të ofruara nga institucionet e Arsimit të Lartë”, në Udhëzimin Nr. 31 datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

GVJ e vizitoi Universitetin EPOKA në mënyrë të organizuar në data 17 dhe 18 qershor 2020. GVJ zhvilloi diskutime me Rektorin, Zv Rektoret dhe Dekanin e Fakultetit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), stafin akademik të Departamentit si dhe me pedagogë të angazhuar në programin e studimit.

GVJ u ndal në detaje të funksionimit të Sekretarisë Mësimore si dhe në detaje të administrimit e procesit mësimor në këtë kohë në Universitetin EPOKA. GVJ vizitoi me përparësi lehtësitë për studentët si sallat e internetit dhe të kompjuterave, bibliotekën, mjediset e studimeve, laboratorët etj. U zhvilluan bashkëbisedime me një grup studentësh duke u njohur me mendimin e tyre për një sërë çështjesh në lidhje me mësimdhënien dhe aspektet e tjera të jetës studentore. Informacioni dhe të dhënat që përmban ky raport bazohen në burimet e sipërpërmendura dokumentare, në takimet e zhvilluara, si dhe në materialet e ndryshme që iu vunë në dispozicion GVJ-së sipas kërkesave.

Koordinator teknik i procedurës është specialistja e ASCAL ME. Renata Qatipi

Më datë 12.08.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 94/26 Prot., datë 12.08.2020 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, “Universiteti EPOKA” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

“Universiteti EPOKA” përcjell përmes sistemit AMS dhe zyrtarisht përgjigjen për Draft-Raportin, me shkresë Nr. 105/10 Prot., datë 19.08.2020 “Komente në lidhje me Draft-RVJ të programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike”. Në këtë dokument institucioni ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm. GVJ, pasi u njoh me komentet, sqaron si më poshtë:

Komenti i IAL:

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) të programit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike vlerëson komentet e paraqitura në Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Konstatimet e detajuara në raport do të merren parasysh me synim të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike.

Në vijim të shpjegimit të dhënë në faqet 3-4 të Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në lidhje me përmbushjen e rekomandimit nr. 2 të lënë nga procesi i mëparshëm i

vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit periodik, GVB rithekson faktin që në programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, çdo lëndë ka një titullar lënde që ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose titullin “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”. Vetëm pedagogët në fjalë janë titullarë lënde dhe mbikëqyrin zbatimin e syllabuseve të lëndëve të ofruara.

Në rastin kur një pedagog me kualifikimin akademik “Master i Shkencave” merr pjesë në leksione, ai angazhohet si asistent-lektor dhe nuk ka mundësi të formulojë ose të ndryshojë silabusin e miratuar të lëndës. Çdo kërkesë për kryerjen e ndryshimeve në silabus nga asistent-lektorët, shqyrtohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga Komiteti Shkencor i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike.

Gjithashtu, GVB thekson faktin që përbërësit e mëposhtëm të çdo syllabusi në programet e studimit të ofruara nga Universiteti “EPOKA” – përfshirë edhe programin e studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike – mund të ndryshohen vetëm me vendim të Dekanatit bazuar në propozimin e Komitetit Shkencor të Departamentit përkatës.

- *Përshkrimi i lëndës (Course description);*
- *Rezultatet e të nxënës të lëndës (Course learning outcomes);*
- *Kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit (Course contribution to program competencies).*

GVJ:

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, dhe në veçanti Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, tabela 12.1, 12.2, 12.3, “Plani mësimor i lidhur me personelin përkatës”, për disa prej lëndëve jepen personel akademik me kualifikimin Master i Shkencave. Kjo paraqitje nuk është në kundërshtim me legjislacionin përkatës, pasi edhe personeli me kualifikimin “Master i Shkencave” mund të aktivizohet në procesin didaktik si “asistent-lektor”, por duhet të identifikohet titullari i lëndës, pra lektori i saj dhe jo vetëm “asistent-lektori”.

Referuar syllabuseve të lëndëve [dok. Syllabus 2017-2018_BA CEN; Syllabus 2018-2019_BA CEN; dhe Syllabus 2019-2020_BA CEN], dhe në veçanti për lëndët të cilat në tabelat e sipërcituara kanë të angazhuar personel me kualifikimin “Master i Shkencave” shohim se nuk është angazhuar asnjë personel tjetër akademik të paktën me gradën shkencore “Doktor”. Në veçanti, gjatë analizës së syllabuseve të disa prej lëndëve si: CEN 206; CEN 303; CEN 309; CEN 311; CEN 323; ENG 103; ENG 104; PHY 101; PHY 104, GVJ nuk kishte të dhëna për titullar të lëndëve me kualifikimin e kërkuar. Kjo pasi si në syllabus ashtu edhe në tabelën 12 të RVB, përmenden vetëm personeli i angazhuar në mësimdhënie me kualifikimin “Master i Shkencave”.

Për sa më sipër, GVJ vlerëson institucionin në lidhje me procedurat që ndjek për miratimin e çdo ndryshimi të propozuar në syllabuset e lëndëve, por për disa lëndë nuk ishte e mundur të identifikohet titullari me kualifikimin e duhur. Kujtojmë që titullari i lëndës jo vetëm që shqyrton propozimet e asistent-lektorëve për ndryshime të mundshme, por gjithashtu është përgjegjës për mbarëvajtjen e të gjithë procesit mësimor si dhe udhëheqjen e asistent-lektorëve për mbarëvajtjen e të gjithë aktivitetit didaktik të parashikuar për lëndën.

Për sa më sipër, vlerësimi i Rekomandimit 2 nuk ndryshon dhe mbetet përmbushet pjesërisht.

Komenti nuk merret parasysh dhe RVJ nuk ndryshon.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi I.1				
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Bazuar në programin e studimit të Ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike”, programi jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat kombëtare, por kontribuon direkt në përgatitjen e specialistëve dhe inxhinierëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit. <i>Referencë: Statutit të Universiteti “EPOKA”, neni 3.</i>			
Kriteri 2. Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit, megjithëse nuk ka të bëjë direkt me fushën e ruajtjes së vlerave kombëtare, mbështet zhvillimet prioritare të kohës në Shqipëri e më gjerë duke kontribuar në përgatitjen e brezit të ri të inxhinierëve në fushën e kompjuterave dhe të teknologjisë së informacioni.			
Kriteri 3. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Misioni dhe objektivat e këtij programi studimi janë të tilla që mundësojnë hedhjen e bazave shkencore dhe përgatitjen teoriko-praktike të nevojshme për formimin e studentëve. Në bazë të programit mësimor të hartuar nga institucioni vërehet mbulimi i njohurive bazë si ato të përgjithshme ashtu dhe ato teknike dhe përmbillen me njohuri specifike në fushën e kompjuterave dhe teknologjisë së informacionit. Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e “ Universitetit EPOKA”. <i>Referencë: DVV dok. [Strategic Plan 2017-2022]</i>			
Kriteri 4. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Duke analizuar programin e studimit GVJ konstaton se programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” i përgjigjet kërkesave të kohës për rritjen e rolit të teknologjisë së informacionit në gjithë aspektet e jetës së përditshme dhe është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit. <i>Referencë: DVV, RVB, Plani mësimor</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton	Grupi i vlerësimit të jashtëm GVJ vuri re përmes konsultime me të gjithë

qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	dokumentacionin e venë në dispozicion (rregulloret bazë, dokumentet e strategjisë ekzistuese dhe të përditësuara) si dhe nga takimet me drejtuesit e institucionit të “Universitetit EPOKA” se programi i studimit është ngritur mbi misionet dhe objektivat e përcaktuara në “Strategjinë e zhvillimit 2018- 2024.		
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Referuar paragrafit 3 dhe Nenit 8 të Statutit të Universitetit EPOKA si dhe bazuar në të gjithë dokumentacionin e venë në dispozicion, Statuti dhe Rregullorja e institucionit përcakton përparësitë e tij akademike dhe vërteton që programet e studimit hartohen dhe sigurohen në përputhje me këto të fundit.		
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” sigurohet në përputhje me fushat akademike dhe orientimet e institucionit “Universiteti EPOKA”. Institucioni, i mbështetur gjithashtu në disa Strategji Kombëtare, ka një nga objektivat kryesore ofrimin e programeve të studimit cilësore në fushën kompjuterike atë dixhitale të përpunimit dhe të transmetimi të informacionit. Në strategjinë e përditësuar, Universitetit EPOKA ka përcaktuar qartë objektivat në paragrafin 4, të cilat janë kërkesa bashkëkohore si për stafin akademik ashtu edhe kërkesa për brezin e ri të inxhinierive.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi I.3	
Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.	<p>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë objektivat mbi aftësimin e studentëve, përfshirjen e kompetencave profesionale, aftësive dhe njohurive që studentët duhet të fitojnë deri në fund të programit të studimit, duke karakterizuar profilin e programit. Programi i studimit organizohet sipas skemës së llojit të lëndëve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, duke shfrytëzuar modele të programeve të ngjashme ndërkombëtare, duke synuar në përgatitjen e një brezi të inxhinierëve të rinj jo vetëm zbatues të inxhinierisë kompjuterike por edhe inovator dhe programues duke synuar në një fushë më të gjerë të lëndëve që mund të trajtohen në të ardhmen.</p> <p>Objektiva të programit të studimit mund të veçojmë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të krijojë, të transmetojë dhe të zhvillojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor me qëllim zhvillimin e shoqërisë, ➤ Të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në të gjitha nivelet e studimit; ➤ Të ndihmojë zhvillimit ekonomik dhe social në nivel kombëtar,

	<p>rajonat dhe madje pretendohet në nivel botëror;</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Të ofrojnë programe studimi në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shoqërisë; ➤ Të kontribuojnë në rritjen e standardeve demokratike të shoqërisë dhe me përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë; ➤ Të kryejnë studime dhe thellime në fusha të veçanta; ➤ Të ofrojnë specializim dhe kualifikim të mjaftueshëm. <p><i>Referencë: DVV, RVB, Plani mësimor</i></p>								
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes DVV, në raportin e përgatitur në vitin 2018 del qartë kërkesa e madhe në vend për specialist në fushën e inxhinierisë kompjuterike, të inxhinierisë software dhe të sistemeve digjitale të përpunimit dhe transmetimit të informacionit. Kryesisht institucioni është mjaftuar në ndjekjen dhe gjurmimin e studentëve të punësuar të cilët janë diplomuar ndërvite në këtë program studimi. Bazuar në këtë dokument të institucionit, rezultojnë një numër i lartë i studentëve të punësuar në kompani private, por nuk jepen burime të të dhënave mënyrën e mbledhjes së tyre dhe besueshmëria.</p> <p>Institucioni nuk ka paraqitur studime të mirëfillta të kërkesave të tregut bazuar në këtë fushë.</p> <p><i>Referencë: The Graduate Outcomes in the Labor Market: Ten Years of Achievements, DVV.</i></p>								
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathësisë e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dosjen e vetë vlerësimit DVV. [dok. Dhjetë vjet Arrijtje]. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" është hartuar sipas nevojave të tregut të punës.</p> <p>Qëllimi i programit BSc në Inxhinierinë Kompjuterike, është të sigurojë përgatitjen e specialistëve në fushën e inxhinierisë kompjuterike, bazuar në programet më të përparura të kohës.</p> <p>Programi u jep studentëve koncepte themelore të inxhinierisë dhe përmes njohjes së veçorive kryesore të përpunimit të sistemeve të informacionit, si në harduer, ashtu edhe në softuer. Në veçanti, synohen njohuritë që mbulojnë bazat e arkitekturës së kompjuterëve dhe sistemeve kompjuterike, çështje që lidhen me projektin dhe integrimin e pajisjeve kompjuterike dhe softuerëve, me njohuri të thelluara të sistemeve operative, gjuhëve programuese, teknikave dhe metodave të inxhinierisë softuerike, parimet dhe teknologji për modelim, modelim dhe menaxhim të bazës së të dhënave etj.</p> <p>Përmbajtja e programit të studimit i përmbahet kërkesave të kohës dhe të tregut në vend dhe rajonit.</p> <p><i>Referencë: Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="564 1809 836 1883">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="836 1809 1054 1883">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1054 1809 1273 1883">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1273 1809 1439 1883">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="564 1883 836 1921"></td> <td data-bbox="836 1883 1054 1921"></td> <td data-bbox="1054 1883 1273 1921"></td> <td data-bbox="1273 1883 1439 1921" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.4
Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Bazuar në materialet në dosjen e vetë vlerësimit GVJ konstaton se institucioni e ka përshkruar qartë në statutin e tij fushat parësore të zhvillimit të tij dhe si rezultat Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është krijuar bazuar në praktikat më të mira nga Universitetet Perëndimore. Dhe që nga ajo kohë, administrata ka punësuar personel akademik të kualifikuar, i ka ofruar Departamentit të gjitha lehtësirat për të zhvilluar leksione me cilësi të lartë, dhe seanca laboratorike me cilësi të lartë. Mjetet ndihmëse si klasat ofrohen në një kampus me cilësi të lartë të sallave të leksioneve, duke përfshirë tabela, <i>smartboard</i>, kompjuter dhe laboratorë kompjuterash, laboratorë elektronikë bashkëkohorë.</p> <p><i>Referencë: DVV, dok [Strategic Plan 2017-2022]</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dosjes fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të stafit akademik të departamentit.</p> <p>Fusha e përgjithshme në inxhinieri kompjuterike, teori informacioni, kriptografi, teori automatazimi, zhvillim softueri, inteligjencë artificiale, sisteme operimi, robotikë, statistikë, metoda numerike; ndërthuret mjaft mirë me fushën akademike të njësisë kryesore në vazhdim të ciklit të dytë të studime dhe ciklit të doktoratës.</p> <p><i>Referencë: Plani mësimor dhe kurrikula e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë (FAE) dhe një nga objektivat kryesore të FAE është të trajnojë inxhinierë me aftësi të larta që janë të gatshëm për punë të mëtejshme akademike dhe për tregun konkurrues të punës. Në rastet e programeve të studimit ndërdisiplinore, lëndët ofrohen nga njësi të ndryshme bazë, por secila lëndë mban kodin e njësisë bazë përkatëse.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.5
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Bazuar në dokumentat e dosjes se vetëvleresimit rezulton se institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit duke bërë ndarjen e detyrave për njësitë dhe stafin sipas përgjegjësiive përkatëse. Ndarja e detyrave mirëorganizohet në fillim të vitit akademik dhe aprovohet nga Dekani i FAE. Disa nga këto detyra janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) mbikëqyrja e tezave të përbashkëta nga dy ose më shumë profesorë të Departamenteve të ndryshme, b) ndarja e pajisjeve dhe laboratorëve të përbashkët, c) ndjekja e studenteve përgjatë vitit akademik si dhe orientimi për praktiken profesionale dhe punimin e diplomës. <p>Disa borde organizohen dhe përbërë nga stafi akademik nga Departamente të ndryshme. Institucioni dëshmon se në fund të vitit akademik përpilohen raporte të brendshme për mbarëvajtjen e detyrave të caktuara.</p> <p><i>Referencë: DVV, dok [Strategic Plan 2017-2022]</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin në dosje DVV [dok. Cooperating Institutions and Organizations (other state institutions, professional organizations)], institucioni ka vendosur një bashkëpunim afatgjatë me rreth 33 kompani private në sektorin e Teknologjisë së Informacionit, siç vërehet edhe nga numrat, institucioni i kushton një vëmendje të veçantë marrëdhënieve bashkëpunuese me institucione homologe të arsimit të lartë në Shqipëri si dhe jashtë saj si dhe me kompani private në vend. Zhvillimi i praktikave profesionale realizohet në bashkëpunim me një numër të madh institucioneve e subjektsh të tjera si shtetërore ashtu edhe private. Nga ana e personelit akademik i kushtohet kujdes këtij procesi për të mundur angazhimin sa më të plotë të studentëve dhe përfitimin maksimal nga ana e tyre. Gjithashtu, praktikat (sidomos të vitit të fundit) shikohen edhe si një mundësi për t'u njohur e për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht hapjen e mundësive për punësimin e tyre të ardhshëm.</p>
<p>Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në materialet në dosjen e vetë vlerësimit, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike që është përgjegjës për programin e studimit, harton në mënyrë periodike raporte analitike mbi përfitimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit, në kontekstin e realizimit të programeve të studimit. Këto raporte ndahen me: a) Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve në përfitimin e marrëveshjeve me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, b) Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare për përfitimet e marrëveshjeve për stafin dhe mobilitetin e studentëve, c) Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe të Diplomuarve mbi punësueshmërinë e të diplomuarve në Inxhinieri Kompjuterike.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Universiteti EPOKA, dëshmon me kontratat që ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me shumë kompani private në vend si dhe institucione shtetërore për realizimin e praktikës mësimore. Bazuar në dokumentacionin në dosje numri i kompanive është 33 dhe institucioneve shtetërore është rreth 18.</p> <p>Për të dhënë më tepër rëndësi edhe bashkëpunimit ndërkombëtar.</p>

	Universiteti EPOKA demonstron se ka vendosur lidhje dhe ka realizuar mobilitete për studentët në degë të tjera me universitetet dhe qendra të huaja në shtete si Itali, Turqi, Gjermani, etj.			
Kriteri 5. Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Institucioni ofron trajnime të mëtejshme profesionale për të diplomuarit në koordinim me partnerë të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë nga academia dhe industria. Shembuj të studentëve të Inxhinierisë Kompjuterike janë: <ul style="list-style-type: none"> i) vizita trajnuese në Shkollën e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike të Studimeve të Aplikuara (Beograd, Serbi); ii) Shkolla Ndërkombëtare e Verës: Studime të Avancuara mbi Biometrikën për Autentifikim të Siguruar në Alghero, Itali; iii) Shkolla Ndërkombëtare Verore për Arkitekturën e Avancuar të Kompjuterave dhe Përpilimin e Sistemeve me Performancë të Lartë dhe të Ndërtuar (ACACES) në Fiuggi, Itali; iv) Ndërmarrjet vendore të krijuara në Tiranë, Shqipëri. Gjithashtu pranë Universitetit EPOKA është ngritur Qendra e Edukimit të Vazhduar, ku janë organizuar një sërë specializimesh si Trajnimi i stafit të Universitetit EPOKA për vendosjen e standarteve ISO; Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë; Komunikimi i brendshëm institucional etj. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislationin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Bazuar në dokumentacionin e dosjes së programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike, i ofruar nga Universiteti EPOKA i licencuar fillimisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Nr. 281, datë 12.03 .2008 me kohëzgjatje prej 4 vite me 240 Kredite. Për të përafuar programin e studimit me sistemin e Bolonjës, në zbatim të Ligjit Nr. 10307, datë 22.07.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9741, Datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar programi u riorganizua në Program studimi i ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” me kohëzgjatje

	<p>normale të studimeve tre (3) vite akademike. Urdhri i MASH Nr. 213, datë 25.05.2012, është urdhëri i riorganizimit, ku programi i studimit është i organizuar në 180 kredite ECTS, sipas Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).</p> <p>Nga analizimi i programit të studimit rezulton se ky program është i organizuar në lëndë dhe module me vlerësim në kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Duhet theksuar se vlerësimi i studentëve në Universitetin “EPOKA” në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike, bëhej në bazë të Sistemit Amerikan të Krediteve dhe ECTS.</p> <p>Programi Bachelor realizon çdo vit 60 kredite ECTS.</p> <p>Programi i studimit është plotësisht në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>Referencë: DVV, RVB, Plani mësimor “Rregullore “Për Studimet Universitare dhe Provimet”.</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh.</p> <p>Kriteri 3. Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Duke analizuar programin mësimor i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike”, GVJ arrin në përfundimin se ai është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 10247, datë 04.03.2010, "Për Kornizë e Kualifikimeve Shqiptare", të ndryshuar.</p> <p>Programi i studimit i Inxhinierisë Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike përkon me Nivelin 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK). Më poshtë janë specifikuar njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studentët në programin Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” do të zotërojnë sipas Nivelit 6 të Kornizës Shqiptare:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Njohuri e përparuar e një fushe të punës ose studimit, që përfshin një kuptim kritik të teorive dhe parimeve në fushën e kompjuterave; ➤ Aftësi të përparuar, demonstrim të zotërimit dhe inovacionit, të nevojshme për të zgjidhur probleme komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar të punës ose studimit. ➤ Kompetenca: Menaxhimi i veprimtarive komplekse teknike, profesionale ose projekteve, duke marrë përgjegjësinë për vendimmarrjen në kontekste të paparashikueshme të punës ose studimit. Marrja përsipër e përgjegjësisë për menaxhimin e zhvillimit profesional të individëve dhe grupeve. <p>Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” është hartuar në mënyrë të tillë që të përmbajë elementët bazë teorikë të nevojshëm për përgatitjen e specialistëve me një bagazh të gjerë, të kompletuar për tu aftësuar në vijim në drejtim të formimit në të specializuar. Për të mundësuar formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale e specialitetesh në realizimin e misionit dhe qëllimit të Universitetit EPOKA, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike synon mbajtjen e kontakteve me tregun e punës dhe përshtatjen me kërkesat e tij, si dhe në ndjekjen e studentëve pas përfundimit të studimeve. Në këtë mënyrë, si dhe nëpërmjet ndjekjes së</p>

	<p>zhvillimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë si brenda ashtu edhe jashtë vendit, synohet të përshtatet e përsoset kurrikula e këtij programi studimi.</p> <p><i>Referencë: Plani mësimor dhe kurrikula e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit ka objektiva të qarta të cilat pasqyrohen tek sylabuset e çdo lënde të cilat janë në përputhje me ato të programit. Përgatitja gjatë periudhës tre vjeçare u krijon mundësinë studentëve të integrohen në tregun e punës dhe gjithashtu formon bazat e nevojshme për të thelluar studimet në nivelin e dytë të studimeve. Kërkesat e tregut të punës për specialistë që diplomohen në këtë profil janë në rritje, ndaj programi i studimit synon plotësimin e tyre me të diplomuar cilësorë.</p> <p><i>Referencë: Kurrikula e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike</i></p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p> <p>Kriteri 6. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Duke analizuar programin e studimit dhe sylabuset përkatëse vërehet se elementët e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" janë në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë". Tipologjitë e lëndëve janë ndryshuar sipas rregullores së re, e cila ka pesë kategori lëndësh kur krahasohet me atë të mëparshmen që ka gjashtë kategori lëndësh. Plani mësimor (kurrikula) dhe sylabuset e programit të studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" janë në përputhje të plotë me VKM-në e sipërpërmendur. Programi i studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike" është një program studimi i ciklit të parë. Ai ka një kohëzgjatje normale prej tre vitesh akademike dhe plotësohet me 180 kredite. Forma e studimeve të programit të ciklit të parë të studimit në Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimit është anglisht. Pas përmbushjes së kritereve për diplomim nga programi i studimit në fjalë sipas rregullores së programit të studimit, studentit i jepet diploma "Bachelor".</p> <p>Grupimi i lëndëve bëhet brenda normave ligjore në fuqi sipas VKM Nr. 41, datë 24.01.2018. Departamenti mund të propozoj ndryshime në kurrikula bazuar në zhvillimet ndërkombëtare dhe kombëtare, duke respektuar legjislacionin kombëtar. Nga periudha e liçensimit nuk janë bërë ndryshime në programin e studimit.</p> <p>Nga shqyrtimi i Planit Mësimor të programit të studimit, shpërndarja e lëndëve dhe moduleve, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, ndarja në kategoritë është si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kategoria A (lëndët e formimit të përgjithshëm /bazë): 33 ECTS (18.3%) - Kategoria B (lëndë të formimit karakterizues: 96 ECTS (53.3%) - Kategoria C (lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup-lëndësh me zgjedhje): 23 ECTS (12.7%) - Kategoria D (lëndë plotësuese dhe praktika profesionale): 22 ECTS

	(12.2%) - Kategoria E (detyrimet përmblylëse/mbrojtja e temës së diplomës): 6 ECTS (3.3%) Numri i përgjithshëm i disiplinave (të thjeshta ose të organizuara në module) të nevojshme për t'u diplomuar, së bashku me Tezen është 30 <i>Referencë: DVV, Plani mësimor "Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka përmbushur standardet institucionale dhe ka marrë akreditimin fillestar dhe periodik në nivelin institucional Nr.92 datë 20.10.2017 për një periudhë 4 vjeçare, përpara se të aplikojë për akreditimin e programit të studimit. Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit plotësojnë kërkesat ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike, i cili ofron programin e studimit Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike", plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".</p> <p>Njësia bazë përbëhet nga të paktën 7 pedagogë të punësuar me kohë të plotë, nga të cilët të paktën tre janë me grada dhe tituj akademike.</p> <p>Kështu, sipas viteve stafi akademik PAE dhe PAK ka këto të dhëna:</p> <p><u>Viti akademik 2019-2020:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 15 PAE (1 Prof.Dr; 2 Prof.Asoc.Dr; 7 Dr., 5 MSc) dhe 2 staf akademik ndihmës me BSc. - 5 PAK (1 Prof. Dr.; 3 Dr.; 1 MSc) <p><u>Viti akademik 2018-2019:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 14 PAE (1 Prof.Dr.; 4 Prof.Asoc; 3 Dr., 6 MSc) - 7 PAK (1 Prof. Dr.; 2 Dr.; 4 MSc) <p><u>Viti akademik 2017-2018:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 PAE (1 Prof.Dr;2 Prof.Asoc; 3 Dr., 4 MSc) - 6 PAK (5 Dr.; 1 MSc.) <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është pjesë e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë. Fakulteti i Inxhinierisë plotëson kriteret minimale të përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në</p>

	<p>Republikën e Shqipërisë", i cili përbëhet nga 3 njësi bazë.</p> <p>Njësia bazë ofron 6 programe të ndryshme studimi në tre cikle të ndryshme studimi dhe të gjitha programet e studimit janë akredituar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.</p> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si njësi kryesore dhe Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike pjesë e Fakultetit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë në programin e studimit në fjalë kishte në total 282 studentë për vitin akademik 2019-2020, dhe raporti pedagog student është: 1:19.</p> <p><i>Referencë: Dosja DVV, RVB Tabela nr. 6.1;6.2;6.3.</i></p> <p><i>Referencë: DVV, RVB, Rregullorja e Fakultetit të Arkitekturës dhe Inxhinierisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Bazuar në RVB, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike në përputhje me objektivat e tij për realizimin me sukses të programit të studimit "Inxhinieri Kompjuterike" kishte organizuar ndjekjen e problematikave të programit të studimit nga ana e Koordinatorit të Programit , i cili ndihmon në përbushjen me sukses të objektivave të programit. Koordinatori për programin e studimit Bachelor në "inxhinieri Kompjuterike" është me gradën MSc.</p> <p>Koordinatori i programit kryen detyrat e përcaktuara në nenin 34 të statutit.</p>
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Njësia kryesore Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë si dhe njësi bazë Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike përgjegjëse për programin e studimit, përbushin detyrimet minimale për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik. Çdo departament ka së paku me 7 pedagogë me kohë të plotë nga të cilët të paktën tre janë me grada dhe tituj akademike bazuar në dokumentacionin sipas dosjes RVB.</p> <p>Kështu, referuar dokumentacionit të dorëzuar, në vitin e fundit akademik 2019-2020, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, i Universitetit Epoka nga 47 staf akademik gjithsej, ka 30 pedagogë me kohë të plotë (pra 64% të stafit total), dhe 17 pedagogë me kohë të pjesshme [RVB, Tab. 1].</p> <p>Pjesë e stafit të brendshëm PAE të Fakultetit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.Dr; - 5 Prof.As.Dr; - 15 Dr; - 9 Msc (2 Dr. ne proces) <p>Në stafin e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1 Prof.Dr, - 1 Prof.Asoc.Dr., - 6 Dr.,

	- 9 MSc.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, si dhe faqen ueb të Universitetit EPOKA, Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, si njësi kryesore përgjegjëse për Programin Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike”, jep në faqen e internetit të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit që ofron, programet e lëndëve përkatëse të secilit program studimi të ofruar. Informacioni është i disponueshëm edhe në sekretarinë mësimore dhe i bëhet i ditur nga ana e kordinatorit të programit të studimit.
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Duke analizuar programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” vihet re se ai është i organizuar në lëndë, trajnim profesional dhe praktika, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Raportet e lëndëve sipas kategorive përkatëse janë brenda normave ligjore në fuqi.
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” është i organizuar në lëndë të vlerësuara me kredite sipas sistemit evropian të transferimit të krediteve ECTS, të ndarë në vite akademike dhe semestra. Çdo semestër ka 30 kredite dhe i gjithë programi i studimit ka 180 kredite. Shpërndarja është në përputhje të normave ligjore në fuqi.
Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	Bazuar në dosjen e programit të studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” ai përmban programe të detajuara lëndore (syllabuse), të cilat përfshijnë informacionin e nevojshëm për ngarkesën e mësimdhënies, orët brenda/jashtë auditorit, ndjekjen e programit dhe metodat e vlerësimit të njohurive, etj. Syllabusi u prezantohet studentëve në ditën e parë të orës së mësimit. Gjithashtu, të gjitha syllabuset publikohen në faqen kryesore ueb të universitetit. Të gjitha syllabuset për të gjitha lëndët e ofruara ishin lehtësisht të aksesueshme në faqen zyrtare të internetit ose nëpërmjet kordinatorit të programit të studimit apo pedagogeve titullar të lëndëve si dhe në sistemin e menaxhimit të brendshëm [EIS]. Syllabusi paraqet në mënyrë të qartë ngarkesën e studentit (orë në auditor dhe jashtë auditorit) të ndara sipas aktiviteteve specifike si Leksione, Seminare, Laboratore, Provime, Detyra kursi etj. Ngarkese e paraqitur në orë është koherente me ngarkesën e kërkuar bazuar me kreditet ECTS të lëndës (25 orë/ECTS). Ndarja e orëve në auditor për aktivitetet specifike nuk është e njëjtë për çdo kredit dhe varet shumë nga natyra e lëndës. Kështu ka lëndë me 6

kredite ECTS që parashikojnë për leksionet 48 orë në auditor, ndërsa lëndë të tjera po me 6 ECTS parashikojnë në auditor 68 orë për leksionet. Kjo edhe në kuadër të lirisë akademike të titullarit të lëndës dhe departamentit përkatës që miraton aktivitetet formuese për çdo lëndë [Dok. Silabus 2017-2018_BA CEN, Syllabus 2018-2019_BA CEN, Silabus 2019-2020_BA CEN].

Gjithashtu, bazuar edhe në rregulloren e provimeve [Annex. 7, Regulation “On Undergraduate Studies And Examinations”], studentët duhet të frekuentojnë të paktën 70% të orëve të leksioneve teorike si dhe të paktën 80% të orëve laboratorike/praktike që të lejohen të marrin pjesë në provimin përfundimtar të lëndës.

Të njëjta informacione jepen për studentët edhe në udhëzuesin e tyre [Annex 9. Smart_Student_Guide_2019-2020].

Vlerësimi i njohurive të përvetësuar nga studentët bëhet sipas kritereve specifike të secilës lëndë, por që të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme [tab. 15 në RVB].

Format e kontrollit të njohurive	Programi i Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike
	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	0-5 %
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10-30%
Testimet gjatë vitit	20-45%
Provimi përfundimtar	30-60 %
Në total	100%

Informacione të detajuara dhe specifike për vlerësimin e secilës lëndë jepet në syllabuset përkatëse. Më poshtë jepet një ekstrakt i mënyrës së vlerësimit për një lëndë specifike të këtij programi studimi [ekstrakt nga dok. Silabus 2019-2020_BA CEN].

COURSE EVALUATION METHOD		
Method	Quantity	Percentage
Midterm Exam(s)	1	20
Project	2	10
Lab/Practical Exams(s)	1	20
Final Exam	1	40
	Total Percent:	100%

Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit si dhe vizitën në institucion programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike u siguron studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike për pranimin, transferimin dhe ekuivalencën e studimeve. Të gjitha rregulloret në lidhje me transferimin e studentëve nga një program studimi në një tjetër brenda institucionit, dhe transferimi i studentëve nga një program studimi të një universiteti tjetër në një

	<p>program studimi të Universitetit “EPOKA” ishin publike në faqen e internetit të Universitetit [http://epoka.edu.al/mat/directives/13.pdf]</p>
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve të përfshira në programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike” janë përgatitur sipas një formati standard dhe integrojnë elementët në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimin e lëndës; • Ngarkesën e lëndës në kredite dhe në orë; • Semestrin kur zhvillohet lënda; • Përshkrimin dhe objektivat e lëndës; • Rezultatet dhe kompetencat e mësimit; • Kontributin e lëndës në rezultatin e programit; • Detyrimet e lëndës; • Laboratorët e parashikuar; • Literaturën bazë; • Literaturën ndihmëse; • Mënyrën e vlerësimit, detajuar me detyrimet e studentit, kriteret e vlerësimit dhe mënyrën e vlerësimit me notë; • Përmbajtjen e temave të kursit. <p>GVJ konstatoi se syllabuset e lëndëve përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm për tu pasqyruar në to dhe se ka një përputhje të mirë me profilin e propozuar. [Dok. Syllabus 2017-2018_BA CEN, Syllabus 2018-2019_BA CEN, Syllabus 2019-2020_BA CEN].</p> <p>Në plotësimin e syllabuseve, për pjesën e titullarit vihet re një ngatërresë e termit “titullar lënde” me “pedagog të lëndës”. Edhe sipas VKM 41 datë 24.01.2018, në syllabus duhet të paraqitet titullari / pedagogu i lëndës dhe syllabusi të jetë i nënshkruar prej titullarit/pedagogut.</p> <p>Megjithatë, në aktet ligjore në fuqi deri në ditën e përpilimit të këtij dokumenti, nuk ka një përkufizim të saktë të termit “titullar të lëndës”. [shih përmbushjen e rekomandimit nr. 2 të lenë nga akreditimi i mëparshëm i këtij programi studimi, i paraqitur në fillim të kësaj RVJ-je].</p> <p>Ne shqyrtimin e syllabuseve të paraqitur nga institucioni për të tre vitet në analizë, vihet re se në shumicën prej tyre jepet si titullar/pedagog personel akademik i kategorisë “Profesor” ose së paku me gradën shkencore “Doktor”. Numri i lëndëve që kanë titullar/pedagog të këtyre kualifikimeve është në rritje vit mbas viti. Megjithatë në disa prej syllabuseve kjo fushë është e plotësuar me personel akademik me kualifikimin “Master i Shkencave”. Nuk është e qartë nëse institucioni, në konfuzionin e përgjithshëm që ekziston për terminologjinë, ka vendosur këtu titullarin apo vetëm lektorin e lëndës.</p> <p>Megjithatë në legjislacionin në fuqi, në dijeninë tonë, nuk ka një</p>

	përkufizim mbi detyrat e titullarit të lëndës dhe peshën që duhet të ketë në mbarëvajtjen e lëndës/ve ku është titullar.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit si dhe vizitën në institucion rezulton se përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike i nënshtrohet përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm. Procedura e përditësimit të programeve është e përcaktuar në “Politikat për Përmirësimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit”. Procedura fillonte në fund të çdo viti akademik, Departamenti analizonte situatën dhe në rast të nevojës për përmirësim, përgatit një draft për kryerjen e përditësimeve. Përditësimi në lëndët e ofruara dorëzohet në Dekanat, dhe pastaj në Rektorat. Rektorati ia përcjell ndryshimet e propozuara Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave. Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave kryen një shqyrtim të detajuar dhe ia paraqet ndryshimet Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë (KPSC) për miratim. Pas miratimit të KPSC, dokumentet i dërgohen Senatit Akademik për miratimin përfundimtar. Procedura dokumentohet sipas sistemit të brendshëm të menaxhimit të dokumentacionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	GVJ konstaton se ngarkesa e programit të studimit është e strukturuar në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ngarkesa e studentëve ka një ekuivalencë të matur në kredite sipas sistemit Evropian të transferimit të krediteve ECTS, çdo semestër organizohet në 30 kredite në një total prej 180 kreditesh për program studimi. Megjithatë, në Universitetin Epoka, organizimi i aktivitetit didaktik edhe pse i organizuar sipas akteve ligjore në fuqi në bazë viti akademik dhe semestra, studentët lejohen të ndjekin aktivitetin didaktik në bazë lëndësh. Kjo lejon që studentët të frekuentojnë deri në 45 kredite ECTS për semestër, gjithmonë me aprovimin e pedagogut tutor dhe të përgjegjësit të njësisë bazë për lëndë të bartura apo lëndë tek të cilat studenti është vlerësuar jo kalues. Ndarja dhe raporti i orëve për secilin zë në kategoritë klasike të mësimdhënies është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. <i>[Annex 9. Smart_Student_Guide_2019-2020, pika 16.3]</i>
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi, përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktikave sigurojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të nevojshme për punësimin e studentëve. Lëndët që përdorin punën laboratorike ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre teknike dhe i bëjnë ata kandidatë shumë të mirë për tregun

	<p>e punës. Zhvillimi i praktikave profesionale parashikohet të realizohet në bashkëpunim me një numër të madh institucionesh e subjektsh të tjera private.</p> <p>Nga ana e personelit akademik i kushtohet kujdes këtij procesi për të mundësuar angazhimin sa më të plotë të studentëve dhe përfitimin maksimal nga ana e tyre. Gjithashtu, praktikat (sidomos të vitit të fundit) shikohen edhe si një mundësi për t'u njohur e për të siguruar lidhje me tregun e punës dhe eventualisht për të hapur mundësinë e punësimit të tyre të ardhshëm.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësisimit profesional.</p>	<p>GVJ konstaton se lëndët e programit të studimit, shpërndarja e tyre në vite dhe semestra, si dhe vlerësimi në kredite dhe orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit si dhe të rezultateve të pritshme të të nxënit dhe të aftësisimit profesional. Studentët e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike janë vlerësuar shumë pozitivisht në disa projekte që kanë marrë pjesë dhe kjo është përdorur si një masë për të vlerësuar kompetencat e fituara në programin e studimit të ofruar.</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>GVJ konstaton se struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa e shprehur në kredite, si dhe raporti i teorisë dhe praktikës janë në përputhje me profilin e programit bachelor dhe të përafëruara me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Studentët e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike janë pranuar me sukses si studentë të transferuar në shkollat më të mira inxhinierike, në universitete amerikane.</p> <p>Nga plani mësimor i paraqitur rezultojnë 1920 orë mësimore në auditor, i ndarë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 1328 orë leksione - 256 orë seminare - 336 orë ushtrime dhe laboratore - Totali 1920 <p><i>Referencë: DVV. RVB, tabela 13</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis pjesës teorike dhe praktikës mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve, mobilitetin dhe punësimin e studentëve në përfundim të programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike. Studentët e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike kanë përfunduar programet e mobilitetit në Universitete në Sh.B.A dhe Evropë, ku gjithmonë është arritur një përputhshmëri midis programeve të studimit të Universitetit "EPOKA" me institucionin pritës (universitetin e huaj).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit si dhe duke analizuar silabuset e lëndëve të ofruara vihet re se ato përditësohen vazhdimisht bazuar në literaturën e kërkuar dhe të rekomanduar të pesë viteve të fundit. Personeli akademik i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike dëshmon se tregun kujdes në përditësimin e silabuseve të lëndës dhe</p>

	literaturës për lëndët teknike me zgjedhje. Fakti që gjuha angleze është gjuha e mësimdhënies së programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike lehtëson mjaft përditësimin e vazhdueshëm të silabuseve me literaturën më të mirë ndërkombëtare në treg.			
Kriteri 7. Përbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<p>Përbajtja e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike garanton përfitim të njohurive, aftësive themelore (aftësive teknike dhe aftësive të tjera), si dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p> <p>Në veçanti, programi Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike synon të aftësimin e studentëve me njohuritë themelore inxhinierike (mendimi kritik, gjetja dhe arsyetimi kritik mbi probleme teknike) si dhe aftësimin e tyre në fushën e IT në përgjithësi. Në veçanti synon të rris aftësitë e studentëve në shkencat e kompjuterike, njohuritë në arkitekturën e kompjuterave, hartimin dhe analizën e algoritmeve dhe inxhinierisë së softuerëve.</p> <p>Programi i studimit përfshin lëndë si “Hyrje në Ekonomi” në mënyrë që studentët të përftojnë edhe njohuri që mund t’i ndihmojnë në nismat e tyre të mëvonshme në fushën e sipërmarrjes.</p> <p>Programi i studimit garanton njohuri të plota për vazhdimin e studimeve të Ciklit të II-të Master i Shkencave apo Master Profesional në fusha të Inxhinierisë Kompjuterike, Softuare, Siguria e Sistemeve të Informacionit.</p>			
Kriteri 8. Përbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Duke analizuar dosjen e vetëvlerësimit, përbajtjen e programit të studimit, GVJ mendon se përbajtja e programit të studimit promovon mundësi të mëtejshme të studimit dhe të punësimin e studentëve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e tregut të punës. Kjo tregohet nga një shkallë e lartë e punësueshmërisë së të diplomuarve të studentëve të Inxhinierisë Kompjuterike në kompani shumë prestigjioze si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Vihet re një numër i lartë i studentëve të diplomuar që janë të punësuar në profilin përkatës.			
Kriteri 9. Për përmirësimin e përbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	GVJ konstaton se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike për të siguruar përmirësimin e përbajtjes së programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike, si dhe përshtatjen e tij me kërkesat e tregut të punës, konsultohet vazhdimisht dhe merr parasysh propozimet e partnerëve nga tregu i punës. Komunikimi është përqendruar në diskutime në lidhje me softëret që zakonisht përdoren në industri, si dhe zhvillimin e aftësive të nevojshme për punën në grup.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.

GVJ konstatoj se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Programi i studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike është mbuluar në masë më të madhe, rreth 90%, me staf akademik më së paku gradën shkencore Doktor. Konkretisht:

GJITHSEJ per vitin akademik **2019 - 2020** kanë dhënë mësim **20 pedagogë** nga të cilët 15 PAE dhe 5 PAK (75% / 25%)

<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>
1 Prof.Dr	1 Prof.Dr.
2 Prof.As.Dr	
7 Dr/PhD	3 Dr.
5 Msc (Dr në proces)	1 Msc (Dr në proces)
0 Msc	0 Msc

GJITHSEJ për vitin akademik **2018 - 2019** kanë dhënë mësim **21 pedagogë** nga të cilët 14 PAE dhe 7 PAK (66% / 33%):

<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>
1 Prof. Dr	1 Prof.Dr.
3 Prof.As.Dr	
4 Dr/PhD	2 Dr
6 Msc (Dr në proces)	1 Msc (Dr në proces)
0 Msc	3

GJITHSEJ për vitin akademik **2017 - 2018** kanë dhënë mësim **17 pedagogë** nga të cilët 11 PAE dhe 6 PAK (64% / 36%).

<u>PAE:</u>	<u>PAK:</u>
1 Prof. Dr	
1 Prof.As.Dr	
5 Dr/PhD	5 Dr/PhD
1 Msc (Dr në proces)	1 Msc (Dr në proces)
3 Msc	

Nga analiza e ngarkesës mësimore paraqitur në tabelën e mëposhtme, rezulton se rreth 80% e ngarkesës përballohet nga personeli akademik efektiv dhe vetëm 20% nga personeli akademik me kontratë. Departamenti ka mobilizuar gjithë kapacitetet e tij duke përballuar pjesën kryesore të ngarkesës. Përballimi i ngarkesës kryesisht nga PAE ndikon pozitivisht në formimin e studentëve, duke qenë se ka një disponibilitet më të lartë të personelit akademik për të ndihmuar studentët në realizimin e programit.

<i>Viti akademik</i>	<i>Ngarkesa mësimore PAE</i>	<i>Ngarkesa mësimore PAK</i>

	<table border="1"> <tr> <td>2019-2020</td> <td>80%</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>2018-2019</td> <td>78.6%</td> <td>21.4%</td> </tr> <tr> <td>2017-2018</td> <td>77.5%</td> <td>22.5%</td> </tr> </table> <p><i>Referencë: DVV, RVB Tabela 7 -Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre .</i></p>	2019-2020	80%	20%	2018-2019	78.6%	21.4%	2017-2018	77.5%	22.5%
2019-2020	80%	20%								
2018-2019	78.6%	21.4%								
2017-2018	77.5%	22.5%								
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Duke analizuar dosjet personale të personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme të angazhuar në programin të studimit, rezulton se të gjithë kanë kualifikimin e duhur akademik në nivelin e kërkuar, për të menaxhuar modulet e lëndëve të programeve të studimit, ato kanë eksperiencë dhe veprimtari shkencore të gjerë.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik publikohen zyrtarisht. Çdo kandidat mund të aplikojë për një nga vendet vakante në rrugë elektronike në faqen përkatëse ueb ose thjesht të dërgojë CV-në në adresën elektronike dhe me pas aplikimet filtrohen dhe përgatitet një listë e shkurtër bazuar në kualifikimet përkatëse; aplikantët e përzgjedhur janë të ftuar në kampus për një leksion të hapur dhe pas një vlerësimi të aplikimit nga Komiteti Shkencor i Departamentit, kandidati i përzgjedhur punësohet.</p>									
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në CV e stafit akademik, niveli i kualifikimit dhe fusha e përgjithshme dhe specifike akademike dhe kërkimore e personelit akademik që mbulon programin e studimit është në përputhje me programin e studimit, me natyrën dhe specifikimet e moduleve të tij. Lektorët punojnë në fushat e kërkimit që përputhen me konceptet e mësuara në programin e studimit bachelor dhe ato përfshijnë elemente të fushës të tyre të kërkimit në lëndë.</p> <p>Një pjesë e stafit janë të huaj, gjë që sjell edhe gërshetimin e metodikave të mësimdhënies dhe një eksperiencë mjaft të mire për studentët të cilët synojnë të vijnë në studimet e tyre në universitete të huaja.</p>									
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike angazhon personelin akademik dhe atë ndihmës për përmbushjen e objektivave të programit. Për këtë departamenti ushtron një rol të veçantë për ekuilibrimin e ngarkesës së personelit në funksion të elementëve të ndryshëm përbërës të programit të studimit.</p> <p>Rezulton se Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë të angazhuar në disa projekte, si midis institucioneve akademike ashtu edhe kompanive. Këto bashkëpunime krijojnë një strukturë të shëndetshme mbështetëse për zhvillimin e tezave të diplomave cilësore dhe praktikave profesionale.</p> <p>Duhet theksuar fakti që praktikës profesionale i jepet një peshë e veçantë në formimin që ofron programi i studimit.</p>									
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të</p>	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se zhvillimi i seancave laboratorike mbështetet prej asistentëve kërkimore kur numri i studentëve është i konsiderueshëm. Kontributi i tyre dhe i personelit administrativ shkon edhe për mirëmbajtjen e laboratorëve.</p> <p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike angazhon personelin akademik</p>									


programit të studimit.	dhe atë ndihmës për përmbushjen e objektivave të programit dhe këtë e konfirmuan edhe studentët gjatë takimit të zhvilluar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	<p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, institucioni ka hartuar rregullore dhe udhëzues në nivel institucional për përmirësimin e metodave të ndryshme dhe bashkëkohore të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve dhe moduleve. Institucioni tregon vullnet në sigurimin dhe përmirësimin e mësimdhënies dhe mjedisit të nxënies.</p> <p>Universiteti “EPOKA” përdor metodologji bashkëkohore të mësimdhënies për të rritur eksperiencat pozitive të nxënies për studentët e tij. Universiteti “EPOKA” vlerëson hulumtimet e personelit akademik në mësimdhënie dhe ka bërë përpjekje për të zhvilluar mënyra krijuese të mësimdhënies. Në fushën e mësimdhënies dhe nxënies jepen vazhdimisht aktivitete trajnuese, te cilat përdoren sipas nevojave të secilit Departament.</p> <p><i>Referuar: Strategjisë së Universiteti “EPOKA” dhe “Politika mbi Zhvillimin e Vazhdueshëm të Programit të Studimit”.</i></p>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	<p>Bazuar në statutin e Universiteti “EPOKA”, institucioni përgjegjës për monitorimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të personelit akademik dhe atij ndihmës akademik i kryen drejtuesi i departamentit.</p> <p>Drejtuesi i Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike analizon në fund të çdo semestri performancën e të gjithë anëtarëve të stafit duke i renditur nga performanca më e lartë në atë më të ulët. Në raste të situatave specifike Përgjegjësi i Departamentit kontakton lektorët për të përçar reagimet. Raporti i përgatitur nga Përgjegjësi i Departamentit dorëzohet në Fakultet dhe më pas në Rektorat për suport vendimmarrës. [Annex 2. Statute of EPOKA]. Gjithashtu, edhe në rregulloret dhe udhëzuesit e Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë jepen mekanizmat vlerësues si për aktivitetet mësimdhënëse, për vlerësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik por edhe të institucionit në tërësi [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html].</p> <p>Edhe gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me përfaqësues të zyrës së cilësisë, u shpjeguan procedurat që ndiqen për</p>

	<p>monitorimin e cilësisë (gjetje) dhe procedurat që ndiqen për përmirësimin e tyre (realizime). Për këtë qëllim, bazuar në raportet e hartuara nga zyra e cilësisë, ngrihen edhe objektivat dhe udhëzimet që duhet të ndërmerren për përmirësimin e gjetjeve. Për këtë përcaktohet një “follow-up” duke përcaktuar objektivat por edhe personat apo autoritetet që ngarkohen për ndjekjen/realizimin e tyre si dhe afatet kohore të realizimit.</p> <p>Edhe pse nuk kemi në dispozicion raporte specifike në lidhje me zbatimin e këtyre mekanizmave për mësimdhënien në këtë program studimi, besojmë se ato janë të zbatueshme sipas procedurave të miratuara.</p> <p>Sipas udhëzimeve të brendshme, mbasi identifikohet/n problematikat jepen rekomandime dhe veprimet që duhet të ndërmerren, kush janë përgjegjësit që duhet të ndjekin veprimet e propozuara, njësitë matëse të rezultatit etj. Sikurse vihet re në dokumentin e përpiluar në lidhje me rekomandimet në tërësi të caktuara nga procedura e vlerësimit të jashtëm në vitin 2017, mekanizmat e brendshëm të institucionit janë zbatuar. [Annex 47. Action Plan_Fulfillment of Recommendation from previous accreditation].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Bazuar në rregulloren dhe statutin e Universitetit “EPOKA”, institucioni garanton pjesëmarrjen e studenteve në vlerësimin periodik të metodës së mësimdhënies dhe vlerësimin e kompetencave. Çdo semestër studentët plotësojnë një pyetësor anonim ku vlerësojnë performancën e pedagogëve. Plotësimi i pyetësorit fillon një muaj para provimeve finale. Kërkesat e studentëve për lëndët me zgjedhje vlerësohen nga Departamenti çdo semestër. Raporti i përgjithshëm i vihet në dispozicion departamentit dhe secilit pedagog duke ruajtur anonimat.</p> <p><i>Referuar: Pyetësor për Vlerësimin e Lektorit të Lëndës.</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit të studimit si dhe të institucionit në tërësi, Departamenti përgjegjës për programin e studimit është edhe përgjegjës për sigurimin e cilësisë në programet që mbulon. Megjithatë institucioni ka të ngritur Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë i cili monitoron cilësinë e mësimdhënies në veçanti si dhe rekomandon dhe ndjek marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë</p> <p>http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-assurance-documents-1404.html</p> <p>Bazuar në dosjen e vetëvlerësimit, struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është Departamenti, studentët ndërmjet sistemit EIS shprehin mendimin e tyre për çdo lëndë duke plotësuar pyetësorin e vlerësimit të lektorit të lëndës.</p> <p>Pyetësori mbi vlerësimin e lektorit të lëndës është një nga mjetet kryesore i përdorur për vëzhgimin e cilësisë të mësimdhënies në Universitetin “EPOKA”. Pyetësori bëhet në bazë semestrale. Rezultatet e plota të pyetësorëve jepen të përmbledhur në Raportit Vjetor i cili publikohet në faqen zyrtare ueb të universitetit “EPOKA”.</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2016-2017.pdf</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018.pdf</p>



	http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	<p>Me qëllim sigurimin e ndërgjegjësimit të të gjithë stafit akademik dhe administrativ mbi rëndësinë e përvetësimit të kulturës së cilësisë nga çdo njësi në Universitetin EPOKA rezultojnë të ngritura dy qendra për kontrollin e cilësisë: Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë (KPSC) dhe Grupi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë (GBSC).</p> <p>Të dyja qendrat rezultojnë të zhvillojnë në bazë periodike seminare informuese dhe trajnuese me stafin e institucionit në lidhje me përbërësit dhe rëndësinë që mbart sigurimi i cilësisë në përgjithësi dhe Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë në veçanti. Gjithashtu rezultojnë se institucioni është i përfshirë në projekte ndërkombëtare dhe ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me universitete ndërkombëtare me të cilat nxit stafin të marrë pjesë në programet e shkëmbimit siç është Erasmus+ KA1 ose KA2 duke përmirësuar aftësitë e tyre të mësimdhënies.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2																				
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.																				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																			
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>GVJ konstatoi se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë një kombinim i metodave tradicionale me ato bashkëkohore të vlerësimit përfundimtar të studentit. Vlerësimi nga pikëpamja akademike e mësimin, projekteve, detyrave, praktikave, seminarëve dhe punëve të ngjashme bëhet në bazë të njësive matëse të orës së performuar në auditor. Vlera e krediteve të një lënde përbëhet nga numri total i orëve javore të pjesës teorike dhe gjysma e orëve javore për pjesën e aplikimit, punës laboratorike, projekteve dhe punimeve të tjera. Gjatë një viti akademik plotësohen të paktën 60 Kredite. Studentët vlerësohen mbi bazën e provimeve të ndërmjetme; provimeve finale; detyrave; prezantimeve dhe projekteve. Metodot e vlerësimit janë të shprehura qartë në silabusin e çdo lënde dhe çdo lektor organizon përqindjen e vlerësimit për secilën pjesë. Llojet e vlerësimit janë: detyrat, koleqiumet, kuizet, projektet, projektet semestrale, pjesëmarrja në mësim, provimet e ndërmjetme dhe provimet finale.</p> <p>Bazuar në planin mësimor (tabela 10 në RVB) si dhe në tabelën 13 në RVB kemi që elementët e studimeve të parashikuara për këtë program studimi në auditor dhe jashtë tij (studim individual i studentit) janë:</p> <table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <thead> <tr> <th></th> <th style="text-align: center;">Në auditor</th> <th style="text-align: center;">Studim individual</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Leksione (orë)</td> <td style="text-align: center;">1328</td> <td style="text-align: center;">1830</td> </tr> <tr> <td>Seminare (orë)</td> <td style="text-align: center;">256</td> <td style="text-align: center;">325</td> </tr> <tr> <td>Ushtrime dhe laboratorë (orë)</td> <td style="text-align: center;">336</td> <td style="text-align: center;">425</td> </tr> <tr> <td>Totali</td> <td style="text-align: center;">1920</td> <td style="text-align: center;">2580</td> </tr> <tr> <td>Totali për program studimi (orë) 180 ECTS x 25 orë/ECTS</td> <td colspan="2" style="text-align: center;">4500</td> </tr> </tbody> </table>			Në auditor	Studim individual	Leksione (orë)	1328	1830	Seminare (orë)	256	325	Ushtrime dhe laboratorë (orë)	336	425	Totali	1920	2580	Totali për program studimi (orë) 180 ECTS x 25 orë/ECTS	4500	
	Në auditor	Studim individual																		
Leksione (orë)	1328	1830																		
Seminare (orë)	256	325																		
Ushtrime dhe laboratorë (orë)	336	425																		
Totali	1920	2580																		
Totali për program studimi (orë) 180 ECTS x 25 orë/ECTS	4500																			

	<p>Ku nga kjo ndarje, kemi edhe përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018, ku në paragrafin 2.1, pika ç) duhet që [... <i>Orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1 500 (njëmijë e pesëqind) orëve mësimore vjetore...</i>]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Personeli akademik monitoronte me kujdes rastet specifike dhe gjithmonë përipiqet të identifikojë kërkesat e studentëve që mund të kenë nevojë. Departamenti përdor sistemin e këshillimit, ku studentët e viteve më lartë punojnë së bashku me studentët e vitit të pare dhe të dytë në lëndët ku ata hasin vështirësi.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me përfaqësues të studentëve të këtij programi studimi, u konfirmua se studentët e nivelit master, sidomos ata që kanë bursë të plotë me meritë akademike, e kanë të detyruar në marrëveshjen me institucionin të japin kontribut në këshillimin e studentëve të viteve më të ulëta.</p> <p>Nga studentët kjo vlerësohej si ndihmë e mirë për përvetësimin e njohurive të ofruara në këtë program studimi.</p> <p>Në këtë program studimi, mënyrat e mësimdhënies përfshijnë pjesën teorike ashtu edhe atë praktike/laboratorike (për lëndët që e kanë të caktuar në syllabus). Gjithashtu edhe materialet mësimore gjenden në formën klasike të librave fizik në bibliotekë, literaturë elektronike si dhe materiale të lëndës të ofruara nga pedagogu nëpërmjet sistemi EIS dhe platformës Moodle [http://lms.epoka.edu.al/] e parë si platformë elektronike Epoka Learning Management System.</p> <p>Një mënyrë alternative që personeli akademik përdor për mësimdhënien është edhe ajo e sistemit online, tashmë e provuar gjatë periudhës së pandemisë.</p> <p>Departamenti ka punësuar asistentë lektorë për të ndihmuar studentët që hasin probleme të caktuara si në rastin e studentëve me simptomën ADHD.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni tregon se mbështet personelin akademik për të përmirësuar kompetencat didaktike dhe pas një vlerësimi lejohen përditësimet e metodave të mësimdhënies bazuar në kërkesën e lektorëve të lëndës. Çdo lektor inkurajohet të vëzhgojë kërkesat e tregut të punës dhe të implementojë mënyra të reja në mësimdhënie. Përditësimet duhet të jenë në përputhje me a) rezultatet e nxënies, b) praktikat më të mira në universitetet më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare dhe c) kërkesat e tregut të punës. Ndryshimet mund të përfshijnë riorganizimin e orëve laboratorike dhe të seminareve.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion rezultojnë se institucioni ka përditësuar e bazën laboratorike me labore me bashkëkohore për ti ardhur më afër përdorimit të teknologjisë bashkëkohore në mësimdhënie dhe temave laboratorike si në rastin e elektronikës dixhitale.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas</p>	<p>Bazuar në dosjet personale të personelit akademik, rezultojnë se ato të gjithë janë të angazhuar në mësimdhënie janë kompetent në njohuritë dhe konceptet e shpjegimit duke përdorur metoda të ndryshme sipas temave. Metodatat e mësimdhënies në Inxhinierinë Kompjuterike përfshijnë</p>

tematikave dhe profilit.	<p>leksionet, seminarat dhe praktikat laboratorike. Një metodë e drejtpërdrejtë për të siguruar kompetencat e lektorit është kontrolli nëse plani mësimor i përgatitur përputhet me brendinë e ofruar nga institucionet ndërkombëtare.</p> <p>Kjo duket edhe nga analiza e të dhënave në tabelën 2 dhe 12 në RVB [dok. RVBP_BA CEN_shqip] dhe formimin e stafit përkatës siç jepet në CV-të e tyre.</p>			
<p>Kriteri 5. Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson dhe përditëson periodikisht mënyrat dhe metodat e mësimdhënies me anë të përdorimit të pyetësorëve mbi vlerësimin e lektorit të lëndës. Pyetësorët janë një nga mjetet kryesore të përdorura për kontrollin e cilësisë të mësimdhënies. Pyetësorët mbahet në bazë semestrale. Raporti i vihet në dispozicion çdo pedagogu dhe strukturave drejtuese.</p> <p>Nga takimi me studentët u konstatua se ky mekanizem kishte funksionuar në disa raste në përmirësimin e mësimdhënies në disa lëndë formuese bazë.</p>			
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Në përgjithësi, personeli akademik në punën e përditshme gjatë procesit mësimor, synon të kalojë nga metoda tradicionale e të mësuarit në metodën e interaktivitetit në procesin mësimor duke synuar rritjen e rolit të punëve praktike, projekteve, integritit në punën shkencore të pedagogëve, punës në grup etj.</p> <p>Përmes këtyre transformimeve synon të nxiten dhe zhvillohen cilësi si: a) kreativiteti; b) puna në grup dhe komunikimi i ndërsjellë; c) ndërgjegjësimi dhe marrja e përgjegjësisë; ç) individualiteti; d) zhvillimin i imagjinatës krijuese dh) zhvillimi i iniciativës për të vepruar; e) Të shprehurit korrekt me shkrim dhe me gojë.</p> <p>Përdorimi i smartbordeve dhe demonstrimet në laborator kompjuterike dhe elektronike janë teknike që ndihmojnë direkt në përçimin e materialit tek studentët.</p> <p>Në të njëjtën kohë Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike po implementonte një Projekt European që fokusohet në implementimin e realitetit virtual në mësim.</p> <p><i>Referuar: http://www.vtech-project.eu/</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në diskutim edhe me pedagogët dhe studentët, GVJ konstaton se mësimdhënia në Universitetin “EPOKA” orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit dhe zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenarë të jetës reale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin

profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga të dhënat e RVB dhe vizita në institucion konstatohet se Universiteti EPOKA zotëron hapësira të mjaftueshme dhe bashkëkohore, si: laboratorë, klasa, zyra, salla konferencash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Klasat dhe auditorët janë të pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për ushtrimin e një procesi mësimor sa më efektiv. Gjithashtu, mjediset janë të kompletuara me sistem kondicionimi, kompjuter, projektor, tabelë interaktive (smart board), internet, etj.</p> <p><i>Referencë: DVV, Planimetrite, RVB tabela 16.</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga konstatimi gjatë vizitës në institucion u vu re se ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë të pajisura me strumenta modernë që përfshijnë projektorët, smartbordet, kompjuterat në laboratorët kompjuterikë dhe instrumentet eksperimentale për laboratorin e elektronikës, internet wireless në të gjithë kampusin për të gjithë studentët dhe stafin dhe një bibliotekë moderne.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Institucioni siguron të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të gjithë stafin akademik dhe studentët duke përfshirë edhe qasje në bibliotekë, internet wireless pa limit, përdorimin e laboratorëve në orare të zgjatura. Personeli akademik dhe studentët në përgjithësi ishin të kënaqur nga infrastruktura e vënë në dispozicion për realizimin me sukses të programit mësimor. Në shërbim të programit të studimit janë edhe 2 laboratorët e informatikës si dhe laboratorin e elektronikës. Këta laboratorë përmbajnë aparataturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të këtij programi.</p> <p><i>[Annex 29. ICTC Office Services]</i></p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Literatura e nevojshme gjendet në formën libri në bibliotekën e universitetit “EPOKA”. Në fillim të çdo semestri të gjithë lektorët me kohë të plotë dhe ata me kohë të pjesshme, ju kërkohet të përcaktojnë librat që planifikojnë të përdorin në mësim. Kërkesat e tyre paraqiten në Departament dhe më pas librat janë të disponueshëm edhe për studentët në bibliotekë. Studentët gjithashtu kanë qasje edhe në formën softëare të materialeve të siguruar nga personeli akademik në platformën online të ndërtuar nga vete institucioni.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizita në institucion, biblioteka e universitetit “EPOKA” ka një mjedis të bollshëm dhe është e pajisur me literaturë cilësore me një numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit. Universiteti EPOKA është i abonuar në bazën të dhënave JSTOR që i mundëson stafit dhe studentëve të Universitetit qasje në një gamë mjaft të gjerë të revistave shkencore dhe burimeve të tjera elektronike të cilat kontribuojnë në realizimin e programit të studimit në përgjithësi si dhe në lidhje me përgatitjen e detyrave, projekteve, temave të diplomimit si dhe të punimeve të tjera individuale.</p>

<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB takimi me drejtuesin e bibliotekës rezulton se gjatë vitit 2019-2020 janë shtuar një sasi e konsiderueshme tekstesh në funksion të këtij programi studimi. Gjithashtu edhe studentët kishin qasje në librari online me adresën zyrtare të emailit emër.mbiemër@epoka.edu.al.</p>			
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Nga të dhënat e RVB dhe vizita në institucion konstatohet se të gjithë studentët dhe veçanërisht studentët e “Inxhinierisë Kompjuterike” kanë qasje në laboratorë (kompjuterike, elektronike) për detyrat e lëndëve dhe tezat e diplomës. Laboratorët kompjuterike përdoren për simulimet në shkallë të lartë pasi ofrojnë fuqi të lartë llogaritëse. Laboratorët elektronike përdoren për projektet dhe detyrat që kanë të bëjnë me shumë me pjesën elektronike/mekanike, sistemet e kontrollit dhe robotikën.</p>			
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Të gjitha lëndët e programit të studimit në fjalë mbështeten nga platformat “Google Meet” dhe “Google Classroom”. Të dyja këto platforma mundësojnë komunikim të drejtpërdrejtë mes lektorëve dhe studentëve, mundësojnë publikimin e shënimeve të mësimi, publikimin e detyrave dhe projekteve, mundësojnë dorëzimin e drejtpërdrejtë të përgjigjeve të studentëve për vlerësim. Institucioni ka siguruar licencën e shërbimeve të kompanisë Microsoft për të gjithë personelin dhe studentët dhe ofron seksione trajnimi për personelin për përdorimin e këtyre shërbimeve.</p>			
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Bazuar në vizitën në institucion rezulton se personeli akademik përdor sistemin e brendshëm, të quajtur “Epoka Interactive System - EIS” të ndërtuar nga vet stafi i institucionit për të shënuar dhe për të ndjekur pjesëmarrjen në mësim të studentëve, për të shfaqur notat e detyrave dhe provimeve dhe për të vëzhguar performancën e studentëve. Koordinatorit dhe këshilluesit e studentëve e përdorin këtë sistem për të monitoruar performancën e përgjithshme të secilit student në çdo program studimi.</p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Departamenti, nëpërmjet korditorit të programit të studimit njofton me email, duke u sugjeruar studentëve fushat e mundshme dhe temat e diplomimit, si dhe pedagogët udhëheqës shkencorë përkatës, ku përcaktohet edhe afati i paraqitjes së kërkesës dhe formularit specifik të diplomimit, i cili pasi plotësohet nga studenti, me asistencën e regjistrarit dhe të tutorit akademik, i paraqitet për miratim Koordinatorit të Programit/Përgjegjësit të Departamentit. Me marrjen e miratimit studenti fillon punën për punimin e tij të diplomës, gjatë të cilës ai mbikëqyret dhe udhëzohet nga udhëheqësi i miratuar shkencor, i cili ndihmon studentin në çdo fazë të këtij punimi, lidhur me: marrjen, analizën e të dhënave, nxjerrjen e konkluzioneve dhe ofrimin e rekomandimeve përfundimtare të punimit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e

studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni konform kërkesave ligjore në shërbim të sigurimit të cilësisë në institucion ka themeluar këto njësi: Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) me nën-njësitë e tij si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve përbën Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë të Universitetit “EPOKA”.</p> <p>Struktura dhe funksionimi i këtyre njësive janë përcaktuar në Statutin e Universitetit “EPOKA” dhe Rregulloren për Funksionimin KPSC dhe Manualit të Sigurimit të Cilësisë të Universitetit “EPOKA”. Gjithashtu, Universiteti ka krijuar Politikën e Cilësisë, i cila mbulon politikatat në lidhje me parimet kryesore dhe standardet e sistemit të menaxhimit të cilësisë në përdorim në Universitetin “EPOKA”. Plani strategjik i Universitetit EPOKA dëshmon për një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Universitetit EPOKA, më 2010, i është akorduar certifikata ISO 9001-2008 mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë për shërbimet e ofruara në nivelin e studimeve universitare dhe pasuniversitare.</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit për cilësinë e mësimdhënies midis personelit akademik dhe studentëve. Ky është një proces i plotë që fillon nga punësimi i pedagogëve përmes një procedure të plotë në përputhje me rregulloren e vetë universitetit. Duke pasur parasysh që gjuha e mësimdhënies është ajo angleze dhe duke marrë parasysh që fusha kërkon azhurnime të vazhdueshme, departamenti ka punësuar rregullisht pedagogë duke përdorur fushat ndërkombëtare të shpalljes së vendeve të lira të punës. Personeli akademik ka marrë pjesë në leksionet e mbajtur nga aplikantët dhe ka shprehur opinionin e tij në procesin e përzgjedhjes.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Institucioni dëshmon se ka mbështetur eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies me qëllim rritjen e cilësisë. Në këtë kuadër institucioni ka përfshuar idenë e pjesëmarrjes së stafit në konferenca të ndryshme për të qenë më afër ideve inovative edhe nga universitete të huaja me më eksperiencë.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes së universitetit EPOKA rezultojnë se ai ka funksionale të tre ciklet e studimit. Në këtë mënyrë, ka një interes të veçantë për kualifikim e personelit akademik Master i Shkencave me kohë të plotë, i cili, për Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike, ishte në proces përgatitje të doktoratës.</p> <p>Institucioni është aktiv edhe në programet e shkëmbimit të stafit akademik në mënyrë që të rriten kualifikimet e tyre nga ana profesionale si dhe në trajnime të ndryshme. [Annex 60. 2018-2019_CEN Department Assessment Database]</p> <p>Raporte të përditësuara mbi kualifikimet dhe trajnimet e stafit të Universitetit Epoka në tërësi jepen edhe në faqen ueb zyrtare të institucionit [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-training-activities-1411.html]</p>

Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	GVJ bazuar në RVB dhe materialet në dosje konstaton se, institucioni për rritjen e performacës së stafit akademi në kuadër të programit Erasmus+ janë nënshkruar ndërmjet universitetit EPOKA dhe një sërë universiteteve perëndimore një numër shumë i madh marrëveshesh, prej të cilave do të përfitojnë studentët dhe stafi akademik.		
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Personeli akademik i institucionit dhe personeli ndihmës akademik përgjegjës për zbatimin e programit të studimit janë të angazhuar për të përmirësuar mësimdhënien dhe zbatimin e metodave të reja. Kjo përfshin caktimin e lektorit më të përshtatshëm për lëndët, duke ofruar sugjerimet e duhura në mënyrë që lëndët specifike të ofrojnë mbështetje për kurrikulat e plota.		
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Kryesisht metodat e përdorura nga ana institucionit ishin tradicionale duke qëndruar koherent me nivelin e studentëve prej vitit të parë. Synohet që mësimdhënia të orientohet drejt zbatimit praktik, nëpërmjet ofrimit e zhvillimit të elementëve të tillë, si: projekte, raste studimi, shembuj praktikë dhe simulime kompjuterike të ndryshme; të cilat nga njëra anë respektojnë dhe nxisin autonominë kërkuese të studentëve, e nga ana tjetër u krijojnë atyre një ambient të përshtatshëm, duke u ofruar mundësinë për të testuar njohuritë e tyre në skenare reale të jetës.		
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht
			Përbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ bazuar në materialet në dosjen e vetë vlerësimit konstaton se institucioni ka hartuar rregullore për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive personale të studentëve. Mënyrat e vlerësimit janë të detajuara në silabusin e secilës lëndë. Studentet informoheshin rregullisht për mënyrën e testimit dhe të vlerësimit. Për këtë çdo pedagog, në përputhje me natyrën e lëndës dhe rëndësinë që ka aspekti aplikativ, përcakton ndarjen/peshën e secilit komponent në vlerësimin përfundimtar dhe i prezantohen studentit me praqtjen e syllabusit të lëndës. <i>Referencë: DVV Syllabuset 2017-2020</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga takimi me studentet dhe materialet e raportuara u konstatua se studentët informohen për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive dhe aftësive profesionale, si dhe aftësitë profesionale dhe kërkimore, të parashikuara në plan-programin e lëndës nga drejtuesi i lëndës. Të gjitha detajet për të gjitha lëndët e ofruara nga Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike për programin e studimit në fjalë publikoheshin rregullisht në internet në faqen zyrtare të institucionit dhe jepeshin nga kordinatori i programit të studimit në fillim të vitit akademik apo në fillim të secilit semestër.

	<i>Referencë: DVV, Policy on Continuous Improvement of Study Program</i>		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	GVJ vuri re se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Silabusi përcakton qartë mënyrën e vlerësimit që ndjek çdo pedagog. Provimet zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. <i>Referencë: DVV, Regulation on Undergraduate studies and Examinations</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Bazuar në RVB dhe DVV dok [Formulari i Vlerësimit të Provimit], kontrolli i njohurive mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe vlerësimin përfundimtar. Nota është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> • Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive 20% • Testimet gjatë vitit 35% • Provimi përfundimtar 45%
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Me qëllim rritjen transparencës dhe eliminimin e formave të abuzimit institucioni Universiteti “EPOKA” përdor sistemet e testimit dhe vlerësimit elektronik. Kryesisht këto sisteme ishin në bazë semestrare, ekspertët e programeve të studimit të caktuar nga fakulteti përkatës për të vlerësuar cilësinë e provimeve, plotësojnë formularin e vlerësimit të provimit për lëndë të rastit në Sistemin Interaktiv të Epokës pas hedhjes së notave të provimeve në sistem. Bazuar në rezultatet e krijuara, Bordi i Provimeve përgatit një raport vjetor dhe e dërgon atë tek Komisionin e Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë, më pas raporti i paraqitet Senatit Akademik dhe i dërgohet në njësi të përkatëse për ndjekjen e çështjeve të ngritura. <i>Referencë: "Për funksionimin e Bordit të Provimeve", Udhëzimit mbi Provimet, Sigurinë e Cilësisë së Provimeve.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Bazuar në DVV dok [Për funksionimin e Bordit të Provimeve], testimi dhe vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale bëhet nga komisionet e provimeve të përbëra nga të paktën dy anëtarë, njëri prej të cilëve është drejtuesi i lëndës. Studentët paraqesin një raport me shkrim që shpjegon të gjithë punën e bërë në praktikën profesionale dhe më pas ata prezantojnë përpara një komisioni të përbërë nga dy anëtar të personelit akademik të Departamentit. Pas çdo semestri një lektor i caktuar vlerëson cilësinë e

	provimeve të zgjedhur në mënyrë rastësore, për të gjitha programet e studimit që ofron institucioni.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	<p>Për realizimin e testimi dhe vlerësimin e të gjitha kompetencave të shkruara në të gjithë Universitetin EPOKA, institucioni ka siguruar një infrastrukturë të veçantë të monitoruar nga stafi i duhur i trajnuar. Procedura konsiston në pajisjen e çdo studenti me një kod provimi dhe dokumenti i provimit i studentëve identifikohet me kodin e provimit. Notat shënohen në sistemin e menaxhimit të arsimit nga pedagogu i lëndës një e dhënë kjo e identifikuar nga kodi i provimit.</p> <p>Menaxhimi i gjithë kësaj procedure mundësohet nga një program softëare i përgatitur nga Zyra e IT e Universitetit EPOKA, që shoqëron studentët dhe kodet e caktuara në mënyrë</p> <p><i>Referencë: dok [Shërbimet e Zyrës së ICTC]</i></p>
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Vlerësimi i aftësive dhe kompetencave shoqërohet me komente ose reagime (nëse është e nevojshme) dhe përfshin rekomandime për procesin mësimor në mënyrë që t'i ndihmojnë studentët të përmirësohen në të ardhmen. Vlerësimi i bazuar në koment dhe vlerësim kryesisht sigurohet në lëndë që janë të bazuara në projekt dhe studentët marrin përshtypje për përmirësim nga mbikëqyrësi dhe komisioni i vlerësimit.</p> <p><i>Referencë: DVV, dok [Sigurinë e Cilësisë së Provimeve].</i></p>
Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.	<p>Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën dhe nuk e tolerojnë kopjimin në provime dhe detyra. Lektorët vlerësojnë me kujdes situatat e dyshimta dhe ndërmarrin veprime në vlerësimin e materialit të paraqitur që mbart elemente kopjimi.</p> <p>Gjithashtu tek programi i çdo lënde bëhet përkrahimi i plagjiaturës me qëllim shmangien e saj nga studentët. Plagjiatura përcaktohet si përdorimi i punës, ideve apo fjalëve të dikujt tjetër. Mund të përfshijë elementet si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Kopjimi e punës së një personi tjetër. ➤ Shkarkim, huamarrja apo blerja nga interneti, e projekteve, punimeve apo detyrave të kursit. ➤ Përdorimi i punës së dikujt tjetër. ➤ Paraqitja e rrejshme e burimeve që janë përdorur. ➤ Lejimi i një personi tjetër për të bërë punën akademike. <p>Bazuar në DVV dok [Student guide], institucioni përdor sistemin komercial TURNITIN për të verifikuar plagjiaturën.</p> <p><i>Referencë: DVV, RVB</i></p>
Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	<p>Rezultatet e kontrollit të aftësive dhe aftësive profesionale bazohen në merita dhe dërgohen me kohë, bazuar në përcaktimet në rregulloret përkatëse dok [Sigurinë e Cilësisë së Provimeve]. Në Universitetin "EPOKA" provimet e ndërmjetme dhe ato përfundimtare vlerësohen në mënyrë anonime duke bërë të mundur një vlerësim të verbër të provimeve të studentëve. Kjo tregon një perspektivë institucionale për të qenë</p>

	objektiv në vlerësim. <i>Referencë: DVV, dok [Sigurinë e Cilësisë së Provimeve].</i>			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Vlerësimi i studentëve në Universitetit "EPOKA" bëhet në bazë të sistemit Amerikan të notave dhe krediteve ECTS. Studentët që kanë ankime në lidhje me notën e marrë mund të aplikojnë për ankesë për notë sipas rregulloreve të institucionit e përshkruar në rregulloren e studimit dhe guidën e studentit. <i>Referencë: DVV, Sistemi i Notave" të Udhëzuesit të Studentëve.</i>			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Procedura e ankimimit dhe shqyrtimi i saj është shtjelluar në mënyrë të detajuar edhe në DVV dok [Regulation on Undergraduate studies and Examinations], ajo përcakton të gjitha etapat që kalon një ankimim deri në zbardhjen e një vendimi përfundimtar dhe procesin e arshivimit të tij.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ mendon se programi Bachelor në "Inxhinieri Kompjuterike", si program studimi i Ciklit të Parë, është ndërtuar me qëllim që të mundësojë formimin, përditësimin, aplikimin e njohurive praktike, analitike profesionale apo kërkimore; si edhe të zhvillojë aftësitë e nevojshme tek të diplomuarit që ata të integrohen më së miri në tregun e punës. Qëllimi i këtij programi studimi është të sigurojë përgatitjen e specialistëve në fushën e inxhinierisë kompjuterike bazuar në programet më të përparuara të kohës. Programi i studimit synon që tu jap studentëve konceptet themelore të inxhinierisë dhe njohjes së veçorive kryesore të përpunimit të sistemeve të informacionit, ndërtimit hardëare dhe softëare të tyre. <i>Referencë: DVV, RVB, Rregullorja e FAE</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Bazuar në RBV dhe DVV dok [Plani mësimor] programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive specifike në fushën e burimeve njerëzore, sociale, të komunikimit dhe bashkëveprimit (përfshirë gjuhën e huaj). Në kurrikulat e Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, studentët duhet të marrin dy lëndë zgjedhore joteknike. Lista e lëndëve me zgjedhje jo teknike përfshin: Shkathtësi të Komunikimit, Hyrje në Ligj, Hyrje në Ekonomi dhe gjithashtu gjuhë të huaja si Gjermanishtja I, Gjermanishtja II, Frëngjishtja etj.
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e	Bazuar në dokumentet e dosjes së vetëvlerësimit Dok [Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike],

çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	konstatohet se në fund të çdo semestri, kompetencat dhe aftësitë e studentëve, të paraqitura në programin e studimit dhe silabuset e secilës lëndë, analizohen dhe rishikohen. Kujdes i veçantë u kushtohet lëndëve që janë në vijimësi të lëndëve të tjera në semestrat pasardhës dhe mbahet komunikim midis lektorëve të lëndëve që janë të ndërlidhura.
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	Bazuar në RVB dhe raportet rezulton se në javën e fundit të programit të lëndës, pedagogu bën një përsëritjeje njohurish dhe konceptesh më thelbësore, e cila orienton studentët mbi strukturën e provimit përfundimtar, si një nga elementët e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të fituara nga ana e studentit gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, duke vënë theksin në analizën dhe të kuptuarit e kompetencave të fituara nga lënda/moduli.
Kriteri 5. Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Bazuar në RVB dhe DVV, dok [<i>Student Satisfaction Survey</i>] personeli akademik zhvillon orë mësimore jo i vetëm në auditor, por në bashkëpunim me industrinë, bizneset dhe sipërmarrjet shumë orë mësimore janë kthyer në leksione të hapura në të cilat kanë marrë pjesë specialistë, emra të njohur të fushës si dhe të ftuar të ndryshëm që kanë ndarë eksperiencën e tyre me studentët.
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	Mësimdhënia kryhet mbi bazën e kompetencave në mënyrë që t'u ofrojë studentëve mundësinë për të zhvilluar kompetencat e tyre në laboratorë dhe praktikë. Studentët kanë një laborator të dedikuar Elektronike për të zhvilluar projektet e tyre. GVJ e vizitoi këtë Laborator.
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.	Bazuar në RVB dhe DVV dok [<i>Alumni Survey</i>], personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve ose çështjeve të caktuara. Kjo pasqyrohet në botimet e zakonshme ndër vite RVB Tab. [22].
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Personeli akademik krijon një atmosferë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara dhe shkencore dhe mbështetje ndaj studentëve. Studentët Bachelor ishin përfshirë në projekte kërkimore nën mbikëqyrjen e personelit akademik të departamentit në kuadër të projekteve dhe punimeve shkencore. <i>Referencë: DVV dok[Student Satisfaction Survey]</i>
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	Bazuar në dosjen e vetë vlerësimit DVV, dok[<i>Student Satisfaction Survey</i>], institucioni promovon zhvillimin e ideve inovative, kërkimet dhe studimet shkencore të avancuara të studentëve, duke u ofruar atyre mbështetje financiare. Bazuar në rregulloret e Universitetit "EPOKA", studentët bachelor të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike janë mbështetur financiarisht si Asistentë të Projektit me kohë të pjesshme gjatë studimeve të tyre për të punuar në projektet Horizon 2020 dhe projekte të tjera në vazhdim. Ndihma financiare që u mor nga studentët Bachelor përfshin Koston e Personelit për kohën e tyre dhe kontributin e tyre në kërkimit shkencore dhe blerjen e pajisjeve për eksperimentet që ata do të kryenin. Përvojë tjetër pozitive në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike ka qenë dërgimi i studentëve Bachelor për trajnime në universitete të tjera partnere përmes granteve të projekteve europiane.

Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në dosjen e vetë vleresimit vërehet se personeli akademik kombinon format e mësimdhënies me institucionet partnere për të mundësuar dhe rritur lëvizshmërinë e studentëve. Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike ka përdorur mundësitë e ofruara nga marrëveshjet e mobilitetit CEEPUS dhe Erasmus, që bëjnë të mundur vizita afatshkurtra të realizuara nga personeli akademik dhe gjatë këtyre programeve të lëvizshmërisë studentët kane përfituar nga metodat e ndryshme të mësimdhënies që kanë ndjekur në universitet të ndryshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Bazuar në dosjen e vetë vleresimit DVV dok. [Regulation on Undergraduate studies and Examinations], institucioni harton një procedurë të veçantë për provimin përfundimtar ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit. Procedura është në përputhje të normave ligjore dhe të cilësisë, ajo bëhet publike dhe studentët informohen përgjatë vitit të 3-të nga ana e kordinatorit të programit të studimit.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.	Bazuar në DVV dok. [Regulation on Undergraduate studies and Examinations], Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike dhe personeli akademik ndihmojnë studentët duke siguruar informacionin, udhëzimet dhe materialet e nevojshme në kuadër të provimit përfundimtar dhe mbrojtjes së diplomës. Çdo student i caktohet një këshilltar akademik që miraton regjistrimin e lëndëve në fillim të çdo semestri, këshillon studentin gjatë gjithë periudhës tre vjeçare të programit të studimit dhe këshillon studentin për procedurat deri në diplomimin përfundimtar.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Bazuar në RVB dhe DVV, dok. [Regulation on Undergraduate studies and Examinations], komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohurive të marra gjatë dy viteve të fundit akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët dhe modulet bazuar në rëndësinë e tyre. Në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike, gjashtë tema kryesore janë zgjedhur për t'u pyetur në Provimin Përfundimtar Gjithëpërfshirës. Çdo lektor i lëndës takohet me studentët gjatë semestrit duke ofruar një përmbledhje të temave që janë në provimin përfundimtar gjithëpërfshirës. Studentët që nuk zgjedhin Provimin Përfundimtar Gjithëpërfshirës dhe kanë një GPA (mesatare notash) kumulative më të lartë se 3.0, zgjedhin temë diplomimi. Në tezën e diplomimit, studentët bachelor të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike punojnë nën mbikëqyrjen e një prej lektorëve në një temë specifike për një semestër të plotë.
Kriteri 4. Personeli akademik	Bazuar në dosjen e vetë vleresimit personeli akademik i departamentit

orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/diplomave.	dëshmon se udhëzon dhe ndihmon studentët në përgatitjen e tezës së diplomës. Në këtë proces angazhohet jo vetëm udhëheqësi i punimit të temës së diplomës por edhe pedagog të tjerë, specialist të fushave përkatëse për të kontribuar më mirë në përgatitjen e një punimi cilësor, në te përfshihet edhe stafi ndihmës akademik.
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Bazuar në DVV dok. [Regulation on Undergraduate studies and Examinations], punimi i diplomës jo domosdoshmërisht duhet të ketë punim praktik, në rastet kur tema përfshin një fushë të tillë departamenti mbështet realizimin e punimit praktik të temës së diplomës. Mbështetja në raste të caktuara mund të përfshijë edhe blerjen e mjeteve laboratorike, si në rastin laboratorit të elektronikës.
Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Bazuar në RVB rezulton se udhëheqësi i tezës së diplomës i përcakton një problem të përshtatshëm studentit dhe më pas e çon atë: a) të kuptojë problemin, b) ndihmon për të identifikuar gjendjen e artit që është në dispozicion, c) për të përcaktuar një qasje për të zgjidhur problemin, ç) për të zgjidhur dhe raportuar në një mënyrë të përshtatshme. Mbikëqyrësi i tezës së diplomës vlerëson nëse teza mund të paraqitet para komisionit apo jo ai jep verdiktin përfundimtar.
Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Bazuar në DVV dok. [Regulation on Undergraduate studies and Examinations], çdo student vlerësohet me notë përfundimtare në përfundim të provimit ose mbrojtjes së Diplomës. Nota bazohet në punën e studentëve gjatë semestrit dhe jepet nga lektori kryesor i lëndës. Në rast të provimit përfundimtar gjithëpërfshirës, nota është notë e përmbledhur e dhënë nga gjashtë pedagogë të ndryshëm.
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Bazuar në [Regulation on Undergraduate studies and Examinations], studentët të cilët plotësojnë kërkesat e plotë të procedurës së diplomimit, si kërkesa për kredite ECTS, notën minimale CGPA, sekretaria mësimore përfundon procedurën zyrtare të diplomimit të studentit. Pas diplomimit "Zyra e Regjistrimeve" përgatit diplomën dhe suplementin e diplomës për studentët e diplomuar sipas afateve kohore dhe rregulloreve. Procedura konsiston në diplomat e studentëve për të gjitha programet e studimit regjistrohen në sistemin interaktiv dhe përgatiten sipas formateve të licencuara dhe të miratuara nga MASR. Të gjitha formatet e diplomës përfshijnë numrin serial të diplomës të dhënë nga autoritetet përkatëse që aprovojnë.
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Çdo student në Universitetin "EPOKA" pajiset me "Suplementin e Diplomës" ku raportohen detajet të programeve të tyre përkatëse të studimit. Gjithashtu, sipas kërkesës, studentët mund të kërkojnë "Përshkrimi i Lëndëve" nga Departamenti.
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion vërejmë se të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas kërkesave të direktivës së vitit përkatës dhe një kopje e tyre arkivohet gjithashtu pas diplomimit të studentëve dhe mbeten në dosjen e tyre studentor në të njëjtën mënyrë siç ishte gjatë periudhës së studimit. Kohë pas kohe studentët kërkojnë dokumente specifike për të provuar statusin e tyre studentor për arsye të ndryshme. Sipas kërkesave të tyre, ekzistojnë lloje të ndryshme të dokumenteve të regjistruara, të lëshuara për t'u përdorur nga

	institucione të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	<p>Universiteti EPOKA ka në organigramën e tij zyrën e Burimeve Njerëzore [Annex 4.1, Organizational scheme of EPOKA]. Zyrë që është përgjegjëse për dokumentimin dhe ndjekjen procedurale të të gjithë stafit akademik dhe administrativ të angazhuar në institucion.</p> <p>Gjatë vizitës në zyrën e Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se kjo zyrë dispononte të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>Në shqyrtimin e tre dosjeve rastësore të personelit të angazhuar në programin e studimit, u vu re plotësia dhe rifreskimi i dokumentacionit sipas kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, në dosjen e një personeli akademik të ftuar kemi titullin “Drejtues Kërkimesh”. Ky titull, bazuar në VKM 786, datë 17.12.1998 është i barasvlershëm me titullin akademik “Profesor”. Dhe si i tillë trajtohet nga institucioni në kategorinë Profesor.</p> <p>Nga zyra e burimeve njerëzore vihet re një organizim i mirë i informacionit të brendshëm e cila bazohet në një sistem informatik si për katalogizimin e të dhënave dixhitale ashtu edhe për referenca praktike në ato fizike dhe vendndodhjen e tyre në arkivë.</p>
Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.	Institucioni, bazuar në nevojat dhe kërkesat e departamenteve/ fakulteteve për staf akademik ndjek procedura të mirë përcaktuara në aktet rregullatorë të brendshëm. Këto akte rregullatorë janë publike në faqen zyrtare ueb të institucionit si dhe në rregulloren përkatëse. [Annex 12, Regulation Staff Recruitment]
Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	<p>Në procedurat e brendshme të përcaktuara dhe me rregullore institucionale, bazuar në nevojat që Departamentet dhe Fakultetet kanë për personel akademik hartohen kriteret specifike.</p> <p>Nevojat specifike, mbasi është marrë edhe miratimi paraprak nga Bordi i</p>

	<p>Lartë i Universitetit i kalojnë zyrës së burimeve njerëzore për ndjekjen e hapave procedurale për rekrutim personeli.</p> <p>Zyra e burimeve njerëzore, ne bazë nevojave shpall njoftime për pozicione vakante në faqen ueb zyrtare të institucionit. Nga konsultimi i faqes ueb [http://hr.EPOKA.edu.al/cat-job-opportunities-1465.html] të institucionit (dt. 26.06.2020) rezultojnë të hapur dy shpallje për pozicione pune. Kriteret specifike të kërkuara për këto pozicione janë të shprehura në gjuhën angleze dhe janë mëse transparente së bashku me kriteret e vlerësimit të kandidatëve. Vendet e shpallura janë aktualisht dy, një për kategorinë lektor dhe një për kategorinë asistent lektor, të dy në departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti EPOKA angazhohet për rekrutimin e stafit akademik me përvojë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Njoftimet për vende vakante së bashku me kriteret specifike që duhet të përmbushë kandidati bëhen publike jo vetëm në faqen ueb të institucionit por publikohen edhe në faqe ueb ndërkombëtare të specializuara për rekrutime stafi akademik me karakter ndërkombëtar.</p> <p>Universiteti EPOKA, mbas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët dhe vlerësimin paraprak të tyre, zhvillon një seancë dëgjimore (leksion të hapur) ku kandidati i përzgjedhur mban një leksion të hapur përpara stafit akademik aktual të universitetit. Kjo procedurë shërben për të vlerësuar aftësitë e kandidatit për të përçarur dijet si dhe aftësinë e tij për të komunikuar në gjuhën angleze në nivele të kuptueshme nga studentët.</p> <p>E gjithë procedura e vlerësimit kryhet nga Komiteti Shkencor i njësisë bazë që ka shpallur pozicionin vakant. Objektiviteti i vlerësimit të kandidatëve vërehet edhe në skedën e pikëzimit përkatëse të përcaktuar në rregullore [Annex 12, Regulation Staff Recruitment].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.2</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Universiteti EPOKA zhvillon aktivitetin në kampusin universitar të ndodhur përgjatë Rrugës Tiranë-Rinas, Km. 12. I gjithë aktiviteti didaktik dhe administrativ zhvillohet në këtë kampus. Ambientet e përdorur kanë të gjitha hapësirat e nevojshme për zhvillimin dhe realizimin e të gjithë aktivitetit didaktik dhe laboratorik të parashikuar për këtë program studimi por edhe për të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni.</p> <p>Ambientet kanë të gjitha kushtet e nevojshme për zhvillimin efektiv të të gjithë procesit didaktik.</p> <p>Universiteti EPOKA ka venë në dispozicion të studentëve/stafit një</p>

	<p>bibliotekë me literaturë në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht, të dedikuara për programet e studimit. Në bibliotekë gjendet edhe literaturë jo specifike për programet e studimit të ofruara nga institucionit, literaturë kjo e pa klasifikuar por që mund të përdoret nga studentët për rritjen dhe formimin e tyre kulturor përtej tematikave universitare.</p>												
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u vu re një angazhim jo i vogël i institucionit për të motivuar stafin akademik në rritjen profesionale të tyre.</p> <p>Kjo vihet re edhe nga publikimet e arritura nga stafi i institucionit i cili paraqitet në nivele të larta të publikimeve në përgjithësi dhe në veçanti të atyre me faktor impakti.</p> <p>Një nga mënyrat që institucioni përdor për të motivuar stafin është ai financiar i cili bazohet në arritjet e stafit në publikime shkencore dhe pjesëmarrje në projekte. Sa më të larta të jenë rezultatet e arritura aq më i lartë është edhe shpërblimi financiar. Rregullat e brendshme të kësaj procedure janë transparente për të gjithë stafin.</p>												
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Institucioni inkurajon përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie. Kjo vërehet edhe në impenjimin e institucionit për të mbështetur me infrastrukturën e nevojshme në zhvillimin modern të mësimdhënies (si vendosja e tabelave interaktive në thuajse çdo auditor apo edhe i sistemeve të video-konferencës në rastet e pjesëmarrjes në aktivitetin didaktik të personave që ndodhen jashtë institucionit.</p> <p>Gjithashtu, në kuadër të rritjes së cilësisë së brendshme në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, organizohen aktivitete të ndryshme trajnuese [http://aeqi.EPOKA.edu.al/cat-training-activities-1411.html].</p>												
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Universiteti EPOKA kë të miratuar në rregulloret e brendshme procedurat dhe kriteret për shpërndarjen e ngarkesës mësimore midis stafit akademik.</p> <p>Personeli akademik dhe ai ndihmës akademik i angazhuar në këtë program studimi ka formimin e kërkuar dhe të nevojshëm për lëndët që mbulon. Kjo duket edhe nga analiza e të dhënave në tabelën 2 dhe 12 në RVB [dok. RVBP_BA CEN_shqip] dhe formimin e stafit përkatës siç jepet në CV-të e tyre.</p> <p>Megjithatë, ngarkesa e kërkuar ndaj stafit akademik vetëm për këtë program studimi është sipas tabelës:</p> <table border="1" data-bbox="719 1574 1374 1832"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Ngarkesa në orë (min – max)</th> <th>Ngarkesa mesatare në orë</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2017 – 2018</td> <td>48 – 176</td> <td>92</td> </tr> <tr> <td>2018 – 2019</td> <td>48 – 240</td> <td>113</td> </tr> <tr> <td>2019 – 2020</td> <td>48 – 208</td> <td>105</td> </tr> </tbody> </table> <p>[përpunim nga tab. 12 në RVB]</p> <p>Ku vihet re një angazhim mesatar për secilin staf akademik në rreth 100 orë në auditor vetëm për këtë program studimi.</p> <p>Nuk kemi informacione të mjaftueshme mbi angazhimi e këtij stafi në</p>	Viti akademik	Ngarkesa në orë (min – max)	Ngarkesa mesatare në orë	2017 – 2018	48 – 176	92	2018 – 2019	48 – 240	113	2019 – 2020	48 – 208	105
Viti akademik	Ngarkesa në orë (min – max)	Ngarkesa mesatare në orë											
2017 – 2018	48 – 176	92											
2018 – 2019	48 – 240	113											
2019 – 2020	48 – 208	105											

	<p>programe te tjera studimi dhe në ngarkesën që mund të kenë përtej programit të studimit që po analizojmë.</p> <p>Të dhënat e plota duhet të përftoheshin nga tabela 4 në RVB, por nga analiza e saj, shohim pasaktësi në përpilim. Në rastin konkret, kërkohet që në këtë tabelë të paraqitet ngarkesa mësimore e stafit të angazhuar në këtë program studimi edhe në programet e tjera brenda institucionit. Plotësimi i kësaj tabele nuk është i saktë, të dhënat e paraqitura nuk përputhen me ato të plotësuara për të njëjtit staf akademik në tabelat 12 po në RVB.</p> <p>Kjo pasaktësi e përpilimit të raportit nuk paragjykon analizën e GVJ pasi nuk ka një kufizim ligjor mbi ngarkesën maksimale të lejuar për stafin akademik në IAL jopublike [Udhëzim nr. 29, dt. 10.09.2018 i Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Kreu III, pika 5].</p> <p>Gjithsesi, për të garantuar një mësimdhënie dhe mësimnxënies sa më cilësore, është e këshillueshme që ngarkesa e stafit akademik të zvogëlohet. Në këtë mënyrë mund të rritet angazhimi i stafit në projekte kërkimore ku përfshihen e kërkimeve dhe njohurive do të mund të pasqyrohen edhe në dijet e përçuar tek studentët.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	<p>Gjatë vizitës në institucion, u konstatua se Universiteti EPOKA siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse.</p> <p>Universiteti EPOKA zhvillon aktivitetin didaktik brenda kampusit universitar të ndodhur përgjatë Rrugës Tiranë-Rinas, km 12. Në këtë kampus ndodhen tre godina. Godina e parë ka kryesisht ambiente administrative, auditorë/salla leksionesh/seminaresh, laboratorë didaktik. Godina e dytë ka kryesisht ambiente leksionesh, mense/bar, bibliotekën dhe ambiente ndihmëse. Godina e tretë është konvikt studentor.</p> <p>Përveç ambienteve të dedikuara për mësimdhënie si salla leksionesh dhe laboratorë dhe biblioteka, vlerësohet shumë pozitive edhe nga studentët prania e ambienteve ndihmëse si bar-restoranti.</p>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi ambientet si salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjediset ndihmëse.</p> <p>Sallat e leksioneve dhe seminareve ishin të pajisura me video-projektor dhe PC fiks në ndihmë të procesit mësimor. Një pjesë e auditorëve ishin të pajisur edhe me tabela interaktive në funksion të një mënyre</p>

<p>përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>mësimdhënie inovative dhe më gjithëpërfshirëse.</p> <p>Në rast nevojë, stafi teknik i brendshëm i institucionit garantonte mbarëvajtjen e të gjithë infrastrukturës IT si dhe suportin edhe të pajisjeve të teknologjisë së informacionit në funksion të mësimdhënies si pajisje video-konference apo suportin interaktiv në sistemin e menaxhimit të procesit mësimor si nga ana e studentëve ashtu edhe nga ana e stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Bazuar edhe nga vizita në institucion, Universiteti EPOKA ka një laborator elektronik në funksion të objektivave të këtij programi studimi. Laboratori është i pajisur me të gjithë strumentat e nevojshëm për një post laboratorik si: Oshiloskop dixhitale, Gjenerator sinjali (Disa janë edhe të frekuencës së lartë deri në 3GHz), analizator spektri deri në 3GHz, bllok ushqimi laboratorik.</p> <p>Laboratori i elektronikës paraqiste disa poste pune, të mjaftueshëm për zhvillimin e aktiviteteve laboratorike në nivel hardëare si FPGA, DSP etj.</p> <p>Gjithashtu, institucioni ofron edhe laboratorë të teknologjisë së informacionit të cilët kanë të instaluar softuer në funksion të programit të studimit. Kompjuterët e këtyre laboratorëve paraqesin karakteristika teknike të afta të përballojnë ngarkesën e kërkuar në simulime dhe aktivitete laboratorike të këtij programi studimi.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Institucioni, sikurse përmendet edhe në Kriterin 3 më sipër, ka në dispozicion tre laborator informatike të pajisur me programe profesionale në funksion të aktivitetit didaktik dhe programeve të studimit që ofron.</p> <p>Nga vizita në institucion, na u konfirmua se laboratorët mund të përdoren nga studentët edhe përtej orarit didaktik të lëndëve përkatëse dhe ti përdorin ato për punimin e detyrave/projekteve të kursit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale institucioni vë në dispozicion jo vetëm mjediset e tij por edhe ato të ofruara nga institucionet me të cilat bashkëpunon [Dok. Annex 34. Cooperating Institutions and Organizations].</p> <p>Gjithashtu vihet re një angazhim në rritje të institucionit për të marrë pjesë në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare. Ku pjesëmarrja në këto projekte shihet si pozitive në tërësi për rritjen e nivelit të institucionit, stafit dhe studentëve. Në veçanti për studentët shihet si mundësi e mirë për zhvillimin e praktikave profesionale apo kërkimit shkencor në nivele ndërkombëtare [http://epoka.edu.al/mat/aeqi/Epoka-Institutional-SER.pdf].</p> <p>Një ekstrakt i aplikimeve të institucionit për projekte në vitet 2014-2017 jepet në tabelle.</p>

Program	2014	2015	2016	2017	Total
AKTI	2	2	2		6
Erasmus	15		2	6	23
Horizon 2020	1	4	2		7
IPA			1		1
Jean Monnet		1	1	1	3
Other	1				1
Grand Total	19	7	8	7	41

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Bazuar në RVB dhe në vizitën në institucion, Universiteti EPOKA disponon një bibliotekë me sipërfaqe rreth 400m ² të pajisur me një fond të gjerë librash, kryesisht në gjuhën angleze por jo vetëm. Biblioteka ka hapësira të mjaftueshme për konsultimin e literaturës fizike me rreth 100 vende (tavolinë/karrige) për konsultim. Gjithashtu disponon edhe PC për konsultimin e bibliotekës virtuale e cila ofrohet në bashkëpunimi me bazën e të dhënave JSTOR [dok. Annex 32. Library_Infrastructure in Service to Study Programs].
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikes së programit të studimit.	Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike kryesisht në gjuhën angleze. Mungesa e literaturës në gjuhën shqipe nuk përbën pengesë për këtë institucioni dhe në veçanti për këtë program studimi pasi ai zhvillohet i gjithi në gjuhën angleze. Literatura e nevojshme për objektivat e këtij programin e studimit, sikurse vihet re edhe ne plan-programet e lëndëve (syllabuse) është e parashikuar në gjuhën angleze. Literatura bazë ose ajo ndihmëse për lëndët gjendet në librarinë fizike ose/dhe në atë virtuale. Gjetja e librave në gjuhën shqipe për këtë program studimi, duke qenë ai dinamik dhe në evolucion shumë të shpejtë në rang botëror, do të sillte literaturë të vjetërsuar për vetë kohën që një literaturë në këtë fushë kërkon që të përkthehet/përshtatet në gjuhën shqipe.
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Studentët dhe stafi i Universitetit EPOKA kanë qasje në një sistem menaxhimi dhe informimi të bibliotekës [http://lib.EPOKA.edu.al/] nga ku mund të konsultojnë gjendjen e librave, mundësitë e leximit të tyre në ambientet e bibliotekës apo të marrjes së tyre të përkohshme jashtë ambienteve të bibliotekës. Gjithashtu, institucioni garanton qasje në koleksionet JSTOR specifike për materiale të lidhura me programet e studimit të ofruara nga Universiteti EPOKA.

<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Biblioteka ofron të gjitha kushtet logjistike për një përdorim efikas të ambienteve. Ambienti është <i>open-space</i> me libra në rafte të organizuara sipas klasifikimit LC (ndarje sipas argumenteve të trajtuar). Ofrohen rreth 100 poste konsultimi me sistem kondicionimi. Ambienti është i pajisur edhe me PC me qasje në internet dhe me mundësi për të përdorur bibliotekën virtuale nga të gjithë studentët dhe stafi.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të brendshme për planifikimin dhe shtimin e fondit të librave/revistave dhe materialeve të tjera të bibliotekës.</p> <p>Kryesisht procedura për shtimin e zërave të bibliotekës kalon nga nevoja e përdoruesve të bibliotekës të cilët paraqesin formularin e aplikimit tek përgjegjësi i njësisë përkatëse, dhe lista totale më pas aprovohet nga Administratori i Institucionit i cili autorizon shtimin e fondit të bibliotekës. Procedura më pas ndiqet nga zyrat përkatëse për prokurimet.</p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Qasja në bibliotekën fizike është i mundur 6 ditë në javë me orare të afishuara publikisht si në hyrje të bibliotekës ashtu edhe në faqen ueb përkatëse.</p> <p>Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë, E Hënë –E Premte, ora 08:30 – 12:30 dhe 13:30 – 19:30 dhe të Shtunën 09:00-13:00.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB, Universiteti EPOKA disponon një sistem të informatizuar të menaxhimit të brendshëm [dok. Annex 30. EIS GuideLine – Lecturer; dok. Annex 31. EIS GuideLine - Students] i cili përdoret online në adresën http://eis.epoka.edu.al/. Ku EIS = EPOKA Interactive System.</p> <p>Sistemi i menaxhimit i informatizuar është në ndihmë dhe në funksion të të gjithë informacionit që lidhet me studentët që nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p>Gjithsesi, dokumentacioni zyrtar trajtohet sipas akteve ligjore/nën ligjore në fuqi nga zyra e sekretarisë mësimore, burimeve njerëzore dhe të gjithë instancave përkatëse të cilat ruajnë kopje fizike/regjistra etj.</p> <p>Nga vizita në institucion, dhe në veçanti me sekretarinë mësimore vihet re përdorimi i sistemit informatik si nga pedagogët ashtu edhe nga sekretaria.</p> <p>Përdorimi efikas i sistemit të menaxhimit lehtëson punën e sekretarisë</p>

	<p>pasi edhe vendndodhja e dokumenteve fizik në institucion është një e dhënë e këtij sistemi që ndihmon personelin për reflektimin e dokumenteve zyrtar edhe në dosjen e gjithsecilit student.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm është një platformë informatike e zhvilluar nga vetë stafi i Universitetit EPOKA dhe azhurnohet me module të reja sa herë lind nevoja.</p> <p>Sistemi i informatizuar është hierarkik dhe me privilegje në bazë të rolit që çdo personel akademik/administrativ apo në çfarëdo roli që ka në institucionin, ka qasje në sistemin EIS dhe të dhënat e ruajtura në të sipas funksionit fizik që mbulon. Kjo garanton edhe privatësinë e qasjes të dokumentacionit në përputhje me legjislacionin në fuqi sikurse edhe lirinë akademike dhe të vlerësimit për të gjithë stafin.</p> <p>Një pjesë e veprimtarisë së menaxhimit të informacionit bazohet edhe në platformën <i>Google</i> e cila lejon përdorimin e adresave të postës elektronike për të gjithë stafin dhe studentët nën domain @epoka.edu.al</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi kryesor i menaxhimit EIS është një platformë informatike e bazuar në role dhe hierarki e cila përdoret në bazë email/fjalëkalim.</p> <p>Të gjithë përdoruesit kanë qasje në të dhënat personale dhe mund të përditësojnë disa prej tyre si CV, foto etj.</p> <p>Akresi është me privilegje [dok. Annex 30. EIS GuideLine – Lecturer; dok. Annex 31. EIS GuideLine - Students] ku gjithsecili prej përdoruesve mund të aksesojë vetëm të dhëna në lidhje dhe të nevojshme për funksionin e tij brenda institucionit.</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi informatik i bazuar me privilegje dhe hierarki, lejon një formë komunikimi interaktiv midis studentëve dhe institucionit si dhe mes stafit dhe institucionit sikurse edhe mes stafit dhe studentëve.</p> <p>Studentët aksesojnë avancimin e tyre akademik, vlerësimet përkatëse, materialet e lëndëve të cilat përditësohen nga stafi akademik dhe aksesohen vetëm nga studentët përkatës në sistem të bazuar në platformën moodle [http://lms.epoka.edu.al/]</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të brendshëm është i automatizuar në nivel raportesh. Raportet krijohen në mënyrë automatike në lidhje me shumë parametra që janë të nevojshme për vendim-marrje institucionale por edhe vendim-marrje departamenti apo administrative.</p> <p>Akresi në këto raporte është i garantuar nga hierarkia dhe privilegjet e secilit përdorues.</p> <p>Në mënyrë automatike krijohen raporte si mbi kalueshmërinë, apo vlerësimin mesatar të studentëve, përdorimi i auditorëve dhe ambienteve laboratorike në bazë orareve apo të tjera.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në</p>	<p>Në faqen ueb të Universitetit EPOKA [EPOKA.edu.al] gjendet informacion në dy gjuhë, atë angleze dhe atë shqipe. Lundrimi në këtë faqe, lejon që të arrihen informacione në lidhje me të gjitha programet e studimit dhe aktivitetet e ofruara nga institucioni.</p>

të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Nga faqe ueb kryesore e institucionit mund të arrihen edhe faqe dytësore (domain sekondar) të cilat janë specifike për një departament [http://cen.epoka.edu.al/] apo funksione të caktuara si biblioteka [http://lib.epoka.edu.al/], zyra e cilësisë [http://aeqi.epoka.edu.al/] etj. Në faqen përkatëse të Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike, përgjegjës për këtë program studimi, gjendet i gjithë informacioni i nevojshëm si për lëndët, personelin akademik të përfshirë, aktivitete të organizuara etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni ka një raport financiar për çdo vit buxhetor të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm (audit i jashtëm). Në raport jepen të dhëna të hollësishme për të ardhurat nga tarifat e shkollimit, për pagat, sigurimet shëndetësore, sigurimet shoqërore, tatimin mbi të ardhurat personale, shpenzimet operative etj. Të dhënat jepen edhe në përqindje relative të të gjithë të ardhurave dhe shpenzimeve të institucionit [Annex 54. BA CEN Revenues].
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologji mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.	Në dispozicion të GJVJ nuk është vendosur një raport financiar i detajuar për program studimi, megjithatë, në raportet vjetore vihet re një analizë analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel institucioni. Nga analiza edhe e rregulloreve të brendshme, vihet re një procedurë e konsoliduar e hartimit të nevojave të brendshme të institucionit në nivel programi studimi të cilat më pas reflektohen edhe në planifikimin e buxhetit të vitit pasardhës. Procedura është transparente edhe për hartimin e nevojave për literaturë dhe pasurimin e bibliotekës me tituj të rinj.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Sipas RVB, Universiteti EPOKA kryen audit të përvitshëm të pasqyrave financiare sipas dispozitave ligjore në fuqi. Vështirësi haset në raportimin e të dhënave financiare të cilat në bazë të dispozitave ligjore në fuqi janë në sipas vitit fiskal (janar-dhjetor) dhe të audituara nga ekspertët përkatës dhe të depozituara në QKB, dhe të dhënave të kërkuar për menaxhimin e brendshëm të programeve të studimit të cilat janë në bazë viti akademik (afërsisht tetor-shtator të

	<p>vitit pasardhës).</p> <p>Bazuar në raportet e kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, dhe në veçanti formati i tabelës 18 në RVB institucioni paraqet një pamje të të ardhurave nga tarifat për dhe gjatë shkollimit.</p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni harton raporte të hollësishme të brendshme si në nivel institucioni ashtu edhe për program studimi.</p> <p>Raporti hartohet nga drejtoria e Përgjithshme e shoqërisë “TurgutOzal Education Sh. A.”.</p> <p>Në formë të përmbledhur, të ardhurat dhe shpenzimet financiare jepen edhe në raportet vjetore (mbi bazë viti akademik) të cilat bëhen publike edhe në faqen ueb të institucionit.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në raportet zyrtare financiare si: Pasqyra e të Ardhurave dhe deklarata e Shpenzimeve të Institucionit, kompania ka një bilanc vjetor pozitiv dhe stabilitet financiar i cili siguron përparimin e institucionit. Ku shpenzimet në nivel institucioni zënë rreth 64% të të ardhurave për vitin akademik 2016-2017, rreth 81% për vitin akademik 2017-2018 dhe për vitin 2018-2019.</p> <p>Në këtë mënyrë institucioni nga pikëpamja financiare garanton zhvillimin e tij perspektiv duke qenë se ka një bilanc pozitiv.</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2016-2017.pdf</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018.pdf</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm të hartuar nga vet institucionit si dhe në rregulloren e Universitetit EPOKA të publikuar në faqen ueb, institucioni ka një organizim të politikave dhe proceduarave transparente që mbulojnë një cikël të plotë akademik nga hyrja e studentëve në vitin e parë akademik deri në përfundim të ciklit përkatës.</p>

	<p>Për programin e studimit Bachelor në “Inxhinieri Kompjuterike”, politikat specifike janë të detajuara në rregulloren përkatëse dhe bëhen publike në udhëzuesin e studentit</p> <p>[Annex 9. Smart_Student_Guide_2019-2020].</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Institucioni, bazuar edhe në rregulloren e fakultetit përgjegjës për këtë program studimi [Annex 51. Rregullorja e FAE], ka politikat dhe procedurat të qarta që garantojnë barazinë dhe të drejta të barabarta për të gjithë studentët dhe kandidatët për student.</p> <p>Edhe rregulloret e programit të studimit dhe ato të brendshme si për përfaqësinë e studentëve janë gjithëpërfshirëse [Dekanati i studentëve: http://dos.epoka.edu.al/]</p> <p>Ndër kriteret e barazisë është edhe vlerësimi me meritë për bursat sipas kriterëve: [Annex 41. Merit Based Scholarship]</p> <p>1 - Bazuar në rezultatet e shkollës së mesme dhe Provimet e Maturës Shtetërore të Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Pikët e bursave janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 6600 ose më shumë 100% ▪ 6400 - 6599.99 75% ▪ 6200 - 6399.99 50% <p>2 - Bursa bazuar në rezultatet e provimit SAT:</p> <p>Pikët e bursave janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ 1350 ose më shumë 100% ▪ 1290 - 1349 75% ▪ 1220 - 1289 50% <p>Institucioni ofron ehe bursa të plota për disa kategori të ndryshme studentësh si bursa për fëmijët e ish-policëve të rënë në krye të detyrës, fëmijëve jetimë, fëmijëve nga komuniteti Romë dhe Egjiptian si dhe gjithashtu sportistëve të dalluar [Annex 42. Social Scholarships].</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve miratohen nga senati akademik. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit [http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html/].</p> <p>Procedurat e aplikimit janë në bazë të udhëzimeve të MASR dhe ndjekin portalin e aplikimit U-Albania sipas periudhës dhe udhëzimeve të përcaktuara nga MASR.</p> <p>Kriteret janë lehtësisht të kuptueshme nga kandidatët për student dhe mund të aksesohen online nga të gjithë të interesuarit.</p> <p>Informacione të detajuara për procedurat e regjistrimit të studentëve jepet në [Annex 48. Registrar_s Office. Procedures on Students Records] dhe për transferimin e studimeve jepet në [Annex 59. Directive on student transfer].</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Universiteti EPOKA harton, miraton dhe publikon kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve. Këto i bën publike në sistemin U-Albania sipas udhëzimeve të MASR por edhe në faqen zyrtare të institucionit [http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html/].</p> <p>Kriteret e veçanta për vitin akademik 2019-2020 janë [Annex 44. Admission Criteria for Bachelor and PICD 2019-2020]:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Notë mesatare jo më të ulët se 7/10 ➤ Note mesatare në lëndët Matematikë dhe Fizikë jo më të ulët se 7/10 ➤ Niveli i zotërimit të gjuhës angleze B1 sipas CEFR. <p>Në kushtet kur ky kriter nuk plotësohet, kandidati për student duhet të ketë fituar të paktën nivelin B1 të një prej testeve ndërkombëtarë, të specifikuar në udhëzimet e MASR. Nga ky kriter përjashtohen kandidatët për studentë, të cilët kanë ndjekur shkollën e mesme në gjuhën angleze.</p> <p>Ne faqen ueb të institucionit jepen edhe kriteret e pranimit për studentët e huaj krahas atyre vendas si dhe kontaktet ku mund të marrin më shumë informacion.</p> <p>[http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-495-1926.html]</p>
<p>Kriteri 5. Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike për programin e studimit, propozohen nga njësitë bazë të fakultetit përkatës, miratohen nga Dekanati i Fakultetit dhe miratohen nga ana e Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit. Kriteret e miratuar dërgohen sipas kuadrit ligjor në ministrinë përkatëse për arsimin si kritere të përzgjedhjes së kandidatëve për vitin e ardhshëm akademik. Të dhëna që më pas përdoren në sistemin U-Albania në nivel kombëtar për rankimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve.</p> <p>Për shtetasit e huaj aplikohen të njëjta kritere si edhe për shtetasit shqiptarë sikurse duket nga analiza e faqes ueb të institucionit për krahasim të kriterëve për studentët ndërkombëtar dhe atyre vendas.</p> <p>[http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-495-1926.html]; http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html].</p>
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Kriteret, programet e studimit, mundësitë e punësimit dhe të dhëna të tjera të nevojshme për një vlerësim sa më objektiv nga kandidatët për student publikohet në faqen zyrtare të institucionit. Këto të dhëna janë edhe pjesë e dokumentit kontraktor të pranuar nga studentët dhe institucioni në momentin e regjistrimit [dok. Shenime nga vizita në institucion], dokument që tregon ecur</p> <p>Gjithashtu, institucioni ka politika të qarta dhe rregullore të brendshme për publikimin e të dhënave në lidhje dhe për universitetin.</p> <p>[Annex 22. External communication policy - EPOKA university] http://admissions.epoka.edu.al/home-admission-criteria-1923-1924.html]</p>

	<p>[http://eis.epoka.edu.al/curricula/2/program]</p> <p>[Annex 23. Media and Public Relations Office Procedures]</p> <p>[Annex 24. Marketing Policy of the study program, its forms, transparency with the public]</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Në Universitetin “EPOKA”, studentët vlerësohen sipas një sistemi të bazuar në notën maksimale të barasvlershme me 4.00. Në programet e të tre cikleve, në mënyrë që studentët të diplomohen, duhet të kenë arritur në përfundim të studimeve një mesatare të përgjithshme prej më së paku 2.00 nga 4.00. Në të njëjtën kohë, studentët mund të marrin çdo semestër një ngarkesë maksimale prej 45 ECTS. Sistemi i vlerësimit të rezultateve të studentëve tek Universiteti “EPOKA” nuk është i bazuar tek kalimi i vitit, por tek kalimi i lëndëve në bazë semestrale.</p> <p>http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Kriteret janë lehtësisht të kuptueshme nga kandidatët për student dhe mund të aksesohen online nga të gjithë të interesuarit.</p> <p>Informacione të detajuara për procedurat e regjistrimit të studentëve dhe për transferimin e studimeve jepet në:</p> <p>[Annex 48. Registrar_s Office. Procedures on Students Records]</p> <p>[Annex 59. Directive on student transfer].</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Të gjitha të dhënat dhe kriteret e nevojshme për vlerësimin e dijeve janë të përcaktuara qartë në plan-programet e çdo lënde.</p> <p>[Syllabus 2017-2018_BA CEN; Silabus 2018-2019_BA CEN; Silabus 2019-2020_BA CEN].</p> <p>Të dhëna të detajuara jepen edhe në sistemin e menaxhimit të brendshëm ku studentët kanë qasje të personalizuar në varësi të programit të studimit dhe lëndëve që duhet të ndjekin.</p> <p>[Annex 31. EIS GuideLine - Students] dhe në udhëzuesit përkatës [Annex 40. Guideline “On Examinations”].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti takimi me përfaqësues të studentëve, vihet re një qasje transparente dhe informuese e institucionit kundrejt studentëve.</p> <p>Studentët janë të qartë për procedurat dhe kriteret që duhen ndjekur për punimin e temës së diplomës, kriteret antiplagjaturë dhe rezultatet e pritshme që duhet të arrijnë. Udhëheqësi i diplomës është përgjegjës për</p>

	ndjekjen e studentit gjatë zhvillimit cilësor të punimit deri në përfundimin e tij.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet: këshillimit me stafin administrativ në momentin që interesohen apo pranohen në programin e studimit.</p> <p>Një rol të veçantë në informimin dhe udhëzimin e studentëve e zë edhe Këshilli i Studentëve (<i>Student Council</i>) [http://dos.epoka.edu.al/cat-student-council-669.html].</p> <p>Të dhëna të detajuara gjenden edhe në udhëzuesin e studentit [Annex 9. Smart_Student_Guide_2019-2020].</p> <p>Gjtihashtu, bazuar edhe në rregulloren e fakultetit përgjegjës për këtë program studimi [Annex 51. Rregullorja e FAE], për çdo student, zgjidhet një pedagog këshillues nga departamenti përkatës. Këshilluesi akademik ndjek studentin gjatë gjithë periudhës së studimeve.</p> <p>Në periudhën e regjistrimit ose të përtëritjes së regjistrimit për semestrin përkatës, studenti plotëson formularët e regjistrimit dhe ia paraqet ato këshilluesit akademik për miratim.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve nëpërmjet: këshillimit me stafin akademik dhe administrativ si në momentin që interesohen apo pranohen në programin e studimit ashtu edhe gjatë karrierës së tyre studentore.</p> <p>Informacione të detajuara gjenden edhe në udhëzuesin e studentit apo edhe në raportet e hartuara nga institucioni si në nivel universiteti ashtu edhe për program studimi.</p>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Shpjegime të shumta mbi ndjekjen e programit, lëndët, detyrimet akademike dhe ato administrative, vlerësimin, praktikën si dhe diplomimin, jepen që në fillim prej stafit të institucionit. Studenti ka qasje të personalizuar në këto informacione në hapësirën private që ai ka në sistemin elektronik të menaxhimit të brendshëm EIS [Annex 30. EIS GuideLine - Lecturer].</p> <p>Detaje specifike jepen edhe në plan-programet e lëndëve që u vihen në dispozicion studentëve si në platformën online ashtu edhe në formë plan-programet e lëndëve [Silabus 2019-2020_BA_CEN].</p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Universiteti EPOKA informon si studentët potencial edhe ata që regjistrohen mbi mundësitë e punësimit që ofrohen në përfundim të këtij programi studimi.</p> <p>Studentët e regjistruar, në mënyrë periodike informohen nga zyra e karrierës mbi mundësitë e punësimit [dok. 43, Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit dhe praktikat].</p> <p>Institucioni organizon çdo vit që prej vitit 2014 panairin e karrierës i cili për këtë vit akademik po zhvillohej ditën që GVJ po kryente vizitën në institucion.</p> <p>Të dhëna të përditësuara gjenden edhe në faqen ueb të zyrës së karrierës [http://cpao.epoka.edu.al/].</p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Përdorimi i platformës interaktive elektronike EIS lejon që studentët të kenë qasje të përditësuar në të gjithë informacionin e nevojshëm për mbarëvajtjen e të gjithë procesit didaktik. Në të gjenden dhe përditësohen të dhëna në lidhje me orari mësimor, plani mësimor, silabuset e lëndëve, orari i transportit nga dhe për në institucion në linjën Durrës-Universitet dhe Tiranë-Universitet dhe anasjelltas.</p>			
<p>Kriteri 5 Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka në përdorim një sistem informatik të brendshëm të personalizuar me nevojat reale të menaxhimit të të gjithë informacionit si për stafin administrativ, atë akademik dhe për studentët. Aksesit në këtë sistem është në bazë të përdorues/fjalëkalim dhe mund të aksesohet nga kudo ku ka një qasje në internet.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>Universiteti EPOKA disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Këto të dhëna hidhen në Regjistrin e Diplomimeve së bashku me numrin e studentëve të regjistruar etj., deklarohen sipas kuadrit ligjor në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Të dhëna të përmbledhura jepen edhe në raportet vjetore (vit akademik) të publikuara zyrtarisht në faqen ueb të institucionit.</p> <p>Në këto raporte gjejmë tabela mbi vlerësimin mesatar të studentëve, kalueshmërinë në përqindje, diplomimin në kohë, punësimin etj.</p> <p>Numri i studentëve në këtë program studimi ka qenë në tre vitet e fundit si më poshtë [dok. RVB, tab. 21]:</p>

Viti akademik	Student të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare
Viti akademik 2017-2018	62	9.2
Viti akademik 2018-2019	87	9.43
Viti akademik 2019-2020	122	9.37
	271	

Raporti specifik për këtë program studimi, i paraqitur në dosje për vlerësim [Annex 57. CEN_Department Annual Report_2018_2019], përmban pasaktësi dhe korrigjime që dukshëm tregojnë që është në formë të pa përfunduar (ka korrigjime dhe informacione për NJSBC dhe jo për GVJ). Kërkohej nga stafi përgjegjës për hartimin e këtij dokumentacioni më shumë kujdes në plotësimin e dosjes me dokumentacion të përditësuar.

http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2016-2017.pdf

http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2017-2018.pdf

http://epoka.edu.al/mat/administration/RAPORTI_VJETOR_2018-2019.pdf

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me përgjegjësit e institucionit dhe ata të programit të studimit, u prezantua edhe aksesimi në platformën e menaxhimit EIS. Qasja në modulën e raporteve bëhet e në bazë të privilegjeve që përdoruesi ka, por në të dalin raporte të hollësishme edhe për statistikat e avancimit akademik, tërheqet apo largimet etj.

Këto raporte jepen edhe të përmbledhura në raportet vjetore të cituara edhe më sipër.

Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.

Të dhënat statistikore disponohen nga institucioni edhe në përmbushje të raporteve dhe udhëzimeve të kërkuara nga drejtori apo seksione të veçanta në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve sikurse janë edhe raportet vjetore.

Gjithashtu, përdorimi i platformës së menaxhimit elektronik të të dhënave lejon një qasje të menjëhershme në performancën akademike të studentit. Të dhënat përfshijnë të gjithë jetën e studentit në Universitetin EPOKA, duke filluar që nga avancimi i tij akademik, të dhënat financiare në lidhje me institucionin, kërkesat e paraqitura për dokumentacione nga zyra të ndryshme brenda institucionit, etj.

Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.

Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti gjatë takimit me sekretarinë mësimore, u vu re përdorimi efektiv dhe efikas i sistemit të menaxhimit elektronik të brendshëm. Në këtë sistem ruhen të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me studentët që nga regjistrimi i tyre deri në përfundim të karrierës studentore. Këtu, dokumentacionin përveçse i azhurnuar në formatin elektronik, për efekte ligjore ruhet edhe në formë shkresore (hard copy). Kjo formë shkresore është lehtësisht e arritshme në arkivën përkatëse me të dhënat e menaxhimit të ruajtura në sistemin informatik.

Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së

Bazuar edhe në vizitën në institucion dhe në veçanti takimi me përfaqësues të zyrës së karrierës, vihet re se Universiteti EPOKA i kushton një rëndësi të veçantë mbledhjes së të dhënave të studentëve të

cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>diplomuar. Kjo shërben edhe si një tregues i cilësisë dhe përdoret për përmirësimin e vazhdueshëm për të ofruar një program studimit që formon profesionist në fushat përkatëse.</p> <p>Këto të dhëna jepen në formë statistikore edhe në raportet vjetore që hartohen nga institucioni dhe publikohen në faqen ueb (shih raportet më sipër).</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	<p>Bazuar në statutin e Universitetit EPOKA [Annex 2. Statute of EPOKA], prania e përfaqësuesve të studentëve është e sanksionuar në të gjitha organet kolegjiale.</p> <p>Në Universitetin EPOKA është i ngritur dhe funksionon edhe Këshilli Studentor i cili organizohet dhe kryen aktivitetin në bazë të statutit të tij [http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/statute-of-student-council.pdf].</p>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Sipas statutit të Universitetit EPOKA [Annex 2. Statute of EPOKA], organet kolegjiale drejtuese janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Senati akademik; - Rektorati; - Dekanati; - Asambleja akademike e njëjësive kryesore; - Këshilli i etikës; - Komisioni i promovimit të stafit akademik; - Komisioni i sigurimit të cilësisë; - Komisioni për marrëdhëniet me studentët; - Komisioni i fitimit të gradave shkencore PhD; - Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë; - Bord i administrimit. <p>Në të gjitha këto organe kolegjiale drejtuese, studentët kanë përfaqësuesit e tyre të cilët vijnë nga radhët e Këshillit Studentor sikurse është e sanksionuar edhe në Statutin e Këshillit Studentor [http://epoka.edu.al/mat/legal-acts/statute-of-student-council].</p> <p>Përveç pjesëmarrjes në organet kolegjiale vendimmarrëse, studentët marrin pjesë edhe në vlerësimin e procesit akademik nëpërmjet pyetësorëve dhe anketimeve për vlerësimin e lëndëve, pedagogëve [<i>Annex 27. Lecturer Evaluation Form, FAE</i>] por edhe të gjitha shërbimeve të</p>

	<i>ofruara nga institucioni në përgjithësi [Annex 37. Student Satisfaction Survey].</i>			
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Ngarkesa e programit të studimit është e shpërndarë në tre vite akademike me një mënyrë uniforme [tab. 10 në RVB] me një ngarkesë në vit 672 orë në auditor dhe 828 studimin individual për vitin e parë; 672 orë në auditor dhe 828 orë studimi individual për vitin e dytë dhe 576 orë në auditor dhe 924 orë studimin individual në vitin e tretë.</p> <p>Ngarkesa më e lartë e studimit individual në vitin e tretë është si pasojë e përgatitjes së temës së diplomës e cila është një punim i studentit.</p> <p>Duke qenë se viti akademik ndahet në dy semestra me nga 14 javë secili, ngarkesa në auditor mesatarisht është 24 orë në javë.</p> <p>Plani mësimor në Universitetin EPOKA nuk është i detajuar në nivel semestri. Sikurse përmendet edhe në RVB dhe u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion, studentët orientohen të zgjedhin lënë edhe të viteve të tjera në varësi të aftësive/nevojave personale. Departamenti përkatës për programin e studimit këshillon studentët që të zgjedhin lëndë semestrale me një minimum ngarkese prej 30 ECTS deri në 45 ECTS për student me lëndë të përsëritura.</p> <p>Plani aktual mësimor i paraqitur është në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018. Me hyrjen në fuqi të VKM 41 në vitin 2018, institucioni ka zbatuar ndryshimet përkatëse në kategorizimin e lëndëve të cilat janë paraqitur në tabelën përkatëse [tab. 11 në RVB].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Me përfshirje e studentëve në grupet e interesit dhe organet kolegjiale vendim-marrëse, institucioni garanton marrjen dhe përfshirjen e opinionit dhe sugjerimeve të studentëve gjatë gjithë procesit të përmirësimit të brendshëm.</p> <p>Mendimi i studentëve jepet kryesisht në formë anketimesh të cilat analizohen në nivel departamenti, fakulteti dhe institucioni.</p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit në institucion mbi procedurat, rregulloret të drejtat dhe detyrimet e tyre.</p> <p>Ne faqen ueb të institucionit dhe sidomos në hapësirën personale të çdo studenti [sistemi EIS] gjenden të publikuara të gjitha procedurat që studentët duhet të ndjekin në raste ankimit të një vlerësimi dhe hapat që ndiqen deri në zgjidhjen e problematikave të mundshme.</p> <p>Në përfundim të çdo semestri, studentët nëpërmjet anketimeve japin opinionin e tyre për të gjitha aspektet e jetës studentore brenda institucionit. [Annex 27. Lecturer Evaluation Form, FAE]; [Annex 37. Student Satisfaction Survey].</p> <p>Nga takimi me studentët në institucion u vu re një komunikim i hapur me stafin akademik dhe atë administrativ çka sillte një qartësim të problematikave dhe një zgjidhje të tyre në mënyrë natyrale dhe frytdhënëse për studentët dhe institucionin.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.6	
Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	<p>Në Universitetin EPOKA vihet re një organizim i detajuar i të gjitha procedurave dhe organeve vendim-marrëse apo këshilluese si për studentët ashtu edhe për vet stafin.</p> <p>Në veçanti, në Universitetin EPOKA është Zyra e Regjistrimit e cila ndjek jetën akademike të studentëve nga regjistrimi deri në diplomim. [Annex 48. Registrar_s Office. Procedures on Students Records].</p> <p>Në shërbim të informimit dhe angazhimit të studentëve jo vetëm në jetën akademike, por edhe në klube dhe organizata të tjera në kuadër të formimit të tyre të përgjithshëm është edhe Këshilli Studentor i përfaqësuar nga Dekanati i Studentëve [Annex 4.1 Organizational scheme of EPOKA]</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<p>Zyra e Regjistrimit së bashku me zyrën e karrierës dhe Këshillin studentor përbëjnë burimin primar të informacionit për studentët. Informacionet jepen të personalizuar në rast kërkese apo nevojë nga studentët por jepen kryesisht edhe në formë udhëzuesish apo manualesh të publikuara në faqen ueb përkatëse.</p> <p>Më pas studentët ndiqen nga pedagogët këshillues akademik (tutor) duke përfshirë këtu jetën e tyre akademike dhe atë shoqërore të lidhur me iniciativat e institucionit.</p> <p>Në këtë kuadër edhe gjatë takimit në institucion, studentët konfirmuan që në institucion orientohen nga organet përkatëse jo vetëm në aspektin akademik por edhe atë shoqëror e social. Studentët e viteve më të larta orientohen, edhe në bazë të aftësive të tyre personale, të ndihmojnë studentët e viteve më të ulëta në avancimin e tyre akademik.</p>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e të Diplomuarve zhvillon aktivitetin e saj në bashkëpunim të ngushtë me drejtuesit e fakulteteve dhe departamenteve [dok. 43, Informimi i studentëve për mundësitë e punësimit dhe praktikat].</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e të Diplomuarve organizon edhe panairin e përvitshëm të punës në ambientet e institucionit çka shihet si një mundësi informuese shumë pozitive nga studentët.</p> <p>Universiteti EPOKA dhe organet e tij, informon studentët edhe për mundësi bashkëpunimi/studimi me institucione partnere [Annex 34. Cooperating Institutions and Organizations (other state institutions, professional organizations)].</p>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe	<p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe e të Diplomuarve përpilon të dhëna statistikore për studentët e diplomuar dhe punësimin e tyre mbas diplomimit [Annex 46. Study of the Labor Market after the exit of the students_Periodical]. Gjithashtu nëpërmjet rrjetit Alumni të dhënat</p>

ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	statistikore bëhen publike edhe në faqen ueb të institucionit [http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-office-1457-1491.html]. Në këtë faqe jepen edhe shembuj të karrierës pas-universitare të studentëve të diplomuar në programet e studimit të ofruara nga Universiteti EPOKA.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në RVB, në Universitetin EPOKA është i ngritur dhe funksional Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC). Funksionimi i këtij komisioni bazohet në koordinimin e punës dhe të dhënave nga tre organe vartëse: Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve. Funksionimi i këtyre organeve garanton sistemin e brendshëm të Sigurimit të Cilësisë në Universitetin EPOKA. Funksionimi i këtyre organeve sanksionohet në rregulloret përkatëse të cilat janë publike dhe të afishuara në faqet ueb përkatëse [http://epoka.edu.al/home-staff-doc-publications-6-404.html], [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-quality-sigurimit-dokumente-1404.html].
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) është një organ kolegjal vendimmarrës. Numri i anëtarëve të këtij komisioni përcaktohet nga senati por jo më pak se 5 (pesë) anëtar. Pjesëmarrës janë nga të paktën një përfaqësues nga çdo njësi kryesore (fakultet) me të paktën gradën shkencore “Doktor” i cili nuk ka angazhime të tjera administrative. Përfaqësohet edhe stafi administrativ me të paktën dy anëtar. Një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm (me karrierë publike të mirënjohur në sigurimin e cilësisë). Nënkryetari i Këshillit Studentor për çështje të sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë. Funksionimi i këtij komisioni bazohet në rregulloren përkatëse [http://EPOKA.edu.al/mat/aeqi/2019_05_15_Regulation_On_the_Organization_and_Functioning_of_the_PCQA_track_changes.pdf].

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë realizohet nga vetë institucionin nëpërmjet mekanizmave dhe strukturave të brendshëm.</p> <p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë në nivel institucioni dhe programi studimi organizohet në mënyrë periodike nga agjencitë përkatëse (ASCAL). Akreditimi institucional është Vendim Bordi i Akreditimi Nr. 92, datë 20.10.2017 apo edhe akreditime të disa programe të tjera studimi të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit dhe gjenden edhe në faqen zyrtar të Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL)</p> <p>[https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-20-21-tetor-2017]</p> <p>[http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html]</p> <p>[https://www.ascal.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit].</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë organizon në mënyrë periodike anketime me studentët. Rezultatet e anketimeve përpunohen dhe rezultatet e përfuara vihen në dispozicion organeve vendimmarrëse për të vlerësuar në tërësi ecurinë e një programi studimi. Gjithashtu të dhënat përdoren në veçanti edhe për vlerësimin në detaje të çdo aspekti që lidhet me veprimtarinë e institucionit.</p> <p>Për programin e studimit në analizë, rezultatet e anketimeve shërbejnë për të vlerësuar aspekte të mësimdhënies të secilit pedagog në mënyrë të detajuar duke filluar që nga niveli apo kuptueshmëria e gjuhës angleze të përdorur e deri në detaje të marrëdhënive të pedagogut me studentët, gatishmërinë e tij për të qartësuar studentët në lidhje me aspekte të caktuara të lëndës që mbulon, cilësinë e materialeve që përdor etj.</p> <p>Për këtë qëllim institucioni ka hartuar edhe politika të brendshme për përmirësimin e vazhdueshëm.</p> <p>[Annex 13. Policy on Continuous Improvement of Study Program].</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p> <p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p> <p>Strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë janë struktura hierarkike organizative. Në rastin e vlerësimit të një programi studimi, procedura fillon në departamentin përgjegjës për atë program.</p> <p>Në varësi të nivelit të ndryshimit të propozuar apo sugjerimet e lindura në nivel departamenti, përcillen në njësinë kryesore përkatëse (fakultet). Institucioni ka procedura të qarta për propozime për ndryshime apo rishikime të programeve të studimit ekzistuese [Annex 10. Curriculum</p>

	<p>Change Proposal Form]</p> <p>Vendimi i departamentit dhe i Dekanit përkatës i përcillen Komisionit të Zhvillimit të Kurrikulave i cili shqyrton propozimet në përputhshmëri me zhvillimin e institucionit.</p> <p>Nga ana institucionale, propozimet e komisionet të Zhvillimit të Kurrikulave i përcillen Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë. Mbas shqyrtimit në të gjitha këto komisione, vendimi përfundimtar për aprovimin e ndryshimeve shqyrtohen ne Senatin Akademik bazuar në relacionet përkatëse të përcjella nga të gjitha zyrat dhe komisionet e përfshira në këtë proces.</p> <p><i>[Annex 13. Policy on Continuous Improvement of Study Program].</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Universiteti EPOKA harton dhe përdor anketime të brendshme për vlerësimin e cilësisë dhe ecurisë së programeve të studimit.</p> <p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) dhe organe vartëse si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve përdorin metodologji vlerësimi dhe instrumente matëse për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur dhe angazhimit të personelit akademik. Burimi kryesor i të dhënave për këto raporte dhe metodologji janë anketimet periodike me studentët [Annex 5. Course Instructor Evaluation Survey].</p> <p>Gjithashtu përdoret si model vlerësimi për stafin akademik angazhimi në tre objektiva primare [Annex 11. Directive Acad Admin Perfor Assess Quality Improv]:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Mësimdhënie ➤ Kërkim shkencor dhe projekte ➤ Angazhimi administrativ <p>Raporte periodike raportohen pranë organeve drejtuese sipas një skeme hierarkike Departament > Dekanat > Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulave > Komisioni i Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë > Senati Akademik</p> <p><i>[Annex 13. Policy on Continuous Improvement of Study Program]</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Institucioni kryen analiza semestrale dhe vjetore për ecurinë e programeve të studimit duke i rishikuar ato në kontekstin e kërkesave të tregut. Rezultatet e anketimeve përbëjnë elementët kyç në vlerësimin e një programi studimi [Annex 37. Student Satisfaction Survey].</p> <p>Anketimet që përdoren nuk janë vetëm ato të përpiluara nga studentët aktual, por edhe ato të plotësuara nga ish studentë në kuadër të strukturës alumni [Annex 38. Alumni Survey].</p> <p>Analiza e anketimeve shërben për vlerësimin dhe orientimin e programit të studimit drejt nevojave të tregut të e tregut shqiptar dhe atij ndërkombëtar sipas rastit.</p> <p>Gjithashtu për çdo program studimi kryhet një studim tregu mbi nevojat</p>

	<p>dhe kërkesat për specialistë të fushës që formohen nga programi i studimit specifik</p> <p><i>[Annex 46. Study of the Labor Market after the exit of the students_Periodical].</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Të gjitha politikat që vihen në shërbim për të siguruar cilësinë e proceseve akademike, ndryshimet apo dhe rishikimet e kurrikulave dhe objektivave të tyre, pasi analizohen në njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit, përcillen pranë organeve eprore sipas një skeme hierarkike Departament > Dekanat > Komisioni për Zhvillimin e Kurrikulave > Komisioni i Përhershëm për Rishikimin e Sigurimit të Cilësisë > Senati Akademik</p> <p><i>[Annex 13. Policy on Continuous Improvement of Study Program].</i></p> <p>Raportet e hartuara në njësinë bazë përgjegjëse për programin e studimit përfshijnë jo vetëm anketimet e studentëve por edhe raporte analitike në lidhje me notat dhe vlerësimet e studentëve. Bordi i Provimeve përgjegjës për vlerësimin e cilësisë së provimeve përgatit gjithashtu raporte vjetore dhe ia paraqet për rishikim Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë dhe Senatit Akademik, ky i fundit shpërndan raportin në të gjitha njësitë e interesuara për ndjekjen e çështjeve të ngritura.</p> <p>Raporte vjetore përpilohen nga institucioni edhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe në veçanti ato të kërkuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Raportet në nivelin institucioni bëhen publike edhe në faqen ueb [http://aeqi.epoka.edu.al/home-annual-reports-1479-2743.html].</p> <p>Gjithashtu, të gjithë aktorët e përfshirë në vlerësimin e cilësisë si në nivelin program studimi ashtu edhe institucional, prej vitit akademik 2018-2019 në Universitetin EPOKA, plotësojnë dhe mirëmbajnë një bazë të dhënash unike në format elektronik. [dok. RVB]. Kjo lejon përpunimin e të dhënave në mënyrë më efikase si dhe përfshirjen e më shumë treguesve në vlerësimin objektiv të cilësisë në tërësi si dhe jep instrumente më objektive në proceset vendimmarrëse.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Bazuar edhe në rregulloret e brendshme të institucionit, raportet e përpiluara shërbejnë për përmirësim të vazhdueshëm në nivelin institucioni dhe programin studimi. Të gjitha zyrat dhe njësitë e përfshira në vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, shpërndajnë raportet në të gjitha njësitë e interesuara për ndjekjen e çështjeve apo gjetjeve të ngritura nga analiza cilësore. Procedura e ndjekur është e mirë përcaktuar në rregulloret e brendshme dhe në politikat e zhvillimit të cilësisë [Annex 25. Quality Policy].</p> <p>Gjithashtu treguesit në raportet individuale për stafin akademik përfshijnë edhe kriteret apo parametrat që secili prej tyre duhet të përmirësojë. Kjo u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion në takimin e organet drejtuese dhe personelin akademik.</p>			
Shkalla e përmbushjes së	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

standardit				X
------------	--	--	--	---

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Raportet periodike të organizuara në nivel departamenti të cilat bazohen kryesisht në anketimet e studentëve përpunohen dhe rezultatet e fituara vihen në dispozicion drejtuesve të departamentit përgjegjës për programin e studimit. Këto të dhëna shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për vlerësimin e mësimdhënies nga stafi akademik.</p> <p>Në mënyrë specifike informacioni i anketimit përmbledhet për çdo pedagog dhe i bëhet e ditur secilit pedagog për përmirësim të vazhdueshëm si dhe përgjegjësit të departamentit përkatës.</p> <p>Të dhënat e anketimeve përpunohen në formë elektronike në sistemin e menaxhimit të brendshëm. Qasja në këto të dhëna bëhet edhe në respekt të përdorimit të të dhënave personale dhe me nivele hierarkie në bazë të rolit që secili punonjës i Universitetit EPOKA ka në institucion.</p> <p>Në vlerësimin e cilësisë për stafin akademik përfshihen përveçse procesit të mësimdhënies, edhe përfshirja në Kërkim shkencor dhe projekte si dhe angazhimi administrativ.</p> <p><i>[Annex 11. Directive Acad Admin Perfor Assess Quality Improv].</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në Universitetin EPOKA, të gjitha procedurat e vlerësimit periodike janë të përcaktuara qartë në rregulloret dhe udhëzimet e funksionimit të të gjitha instancave të përfshira në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. I gjithë procesi i vlerësimit të cilësisë, pasi analizohet nga instancat përkatëse për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave, raportohet në instancat kolegjiale vendimmarrëse. Universiteti EPOKA, në shërbim të marrjes së informacionit, përpunimit të tij dhe nxjerrjes së rezultateve përdor si formë të drejtpërdrejtë pyetësorët/anketimet për marrjen e të dhënave dhe si formë të tërthortë, tryezat dhe takimet me studentët, bashkëbisedimet etj. Gjithashtu si një tregues për cilësinë e programit të studimit, e përdorur në Departamentin e Inxhinierisë Kompjuterike, është edhe përfshirja e studentëve në bashkautorësi me stafin akademik në botime shkencore. Element tjetër vlerësues i cilësisë së stafit akademik është edhe numri dhe niveli i publikimeve të stafit të Universitetit EPOKA në bashkëpunim me kolegë nga universitetet të tjera jashtë Shqipërisë.</p> <p>Nuk ka një mekanizëm të veçantë kontrolli për këtë program studimi, formatet janë të njëjta për të gjitha programet e tjera të studimit të ofruara nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i</p>	<p>Aktiviteti i monitorimit organizohet nga njësitë përkatëse në Universitetin EPOKA për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre raportohen në përfundim pranë Senatit Akademik. Metodologjia e vlerësimit mbështetet mbi vetë</p>

<p>cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>deklarimin. Ndërsa instrumentet për ta arritur këtë gjë kanë qenë pyetësorët në rastin e studentëve; dhe në rastin e stafit akademik dhe administrativ, pyetësorët dhe vetëvlerësimin. Rezultatet e marra nga pyetësorët, të përmbledhura e të përpunuara, bëhen publike. Marrja e informacionit nga studentet, bëhet nëpërmjet pyetësorëve dhe takimet me studentet. Ndërsa për stafin akademik, përdoret raportet për ecurinë e fakultetit nga dekani dhe përgjegjësi i departamentit për departamentin si dhe vet-raportimi i stafit akademik në fund të vitit, mbi aktivitetin akademik, përmbushja e objektivave vjetor institucional e atyre personal si dhe mbi detyrat administrative që ata kryejnë. Analiza e këtyre të dhënave reflektohet në raportet vjetore që njësitë kryesore dorëzojnë pranë rektoratit. Pyetësorët janë organizuar në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Pyetësorët janë përqendruar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlerësimin e stafit akademik/ndihmës akademik nga studentet [Annex 27. Lecturer Evaluation Form, FAE]; - Vlerësimin e cilësisë së provimeve nga Bordi i Provimeve [Annex 16. Exam Assessment Form]; - Vlerësimin e studentëve për infrastrukturën në shërbim të programit të studimit; - Vlerësimin nga studentët për shërbimet e ofruara në tërësi nga Universiteti EPOKA [Annex 37. Student Satisfaction Survey]. <p>Në rast ankesash apo vlerësime të ulëta në kriteret e vlerësimit të cilësisë, organet vendimmarrëse kanë mekanizma të përcaktuara qartë për ndjekjen dhe përmirësimin e cilësisë në tërësi [Annex 40. Guideline On Examinations].</p> <p>Në rast vlerësimi të ulët në mësimdhënie apo në provime, drejtuesi i njësisë bazë (përgjegjës departamenti) dhe ai i njësisë kryesore (dekan) zhvillojnë vëzhgime në klasë në formë të leksioneve të hapura [Annex 6. Directive On the Functioning of the Exam Board].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.</p>	<p>Institucioni vlerëson jo vetëm përgjigjet e pyetësorëve për përmirësimin e vazhdueshëm, por gjithashtu vlerëson edhe angazhimin në kërkim shkencor, projekte dhe angazhimi administrativ si nga stafi i institucionit ashtu edhe nga studentët.</p> <p>Kjo tregon edhe punën në grup dhe marrjen e njohurive të përgjithshme dhe specifike nga studentët gjatë periudhës studentore, sidomos në përfshirjen e tyre në botime apo projekte kërkimore. Një përmbledhje e kësaj përfshirje në departamentin përgjegjës për programin e studimit gjendet në: [Annex 60. 2018-2019_CEN Department Assessment Database].</p> <p>Aftësitë e studentëve, por edhe aftësitë e stafit akademik për të transmetuar njohuri vihet re edhe në pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet të ndryshme në kuadër edhe të klubeve të organizuara në nivel institucioni [http://clubs.EPOKA.edu.al/] çka vlerësohet pozitivisht në vet-vlerësimin e institucioni.</p>

	Në Universitetin Epoka është ngritur edhe rrejtja Alumni. Të dhënat dhe pyetësorë e zhvilluar me ish studentë përdoren për përmirësimin në vazhdim të institucionit. [dok. 55.1, Plani i aktiviteteve Alumni; dok. 55.2, Fokus Grup me Alumni; dok. 55.3 Takime të Alumni]. Për programin specifik nuk ka akoma student të diplomuar pasi është brezi i parë që arrin në përfundim të këtij programi studimi për këtë vit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	<p>Të gjithë aktorët dhe organet e përfshira në sigurimin e cilësisë në Universitetin EPOKA veprojnë në bazë të rregulloreve të qarta të brendshme. Në bazë të tyre sanksionohen të gjitha procedurat që nga vlerësimi i cilësisë në tërësi dhe deri në zgjidhjen e problematikave të mundshme që mund të dalin.</p> <p>Për të garantuar paanësi dhe objektivitet në vlerësimin e cilësisë në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë ka në përbërjen e tij një ekspert publik i cili nuk është pjesë e stafit të Universitetit. [http://EPOKA.edu.al/mat/aeqi/2019_05_15_Regulation_On_the_Organization_and_Functioning_of_the_PCQA_track_changes.pdf].</p> <p>Në kuadër të rritjes së cilësisë vlerësohet pozitive edhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare si për studentët ashtu edhe për stafin [Annex 58. Report of benefits from cooperation activities].</p>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	<p>Bazuar në RVB, sikurse u konstatua edhe gjatë vizitës në institucion, u vë re se strukturat e brendshme përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë kanë detyra të përcaktuara qartë dhe me aktet rregullatorë të brendshme.</p> <p>Në kuadër të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë, në Universitetin EPOKA janë të paktën dy struktura të cilat kanë objektiva të qarta dhe drejtpërdrejtë të lidhura me këtë objektivi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë; - Bordi i Vlerësimit të Kurrikulave.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik,	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) është një organ kolegjal vendimmarrës. Numri i anëtarëve të këtij komisioni përcaktohet nga senati por jo më pak se 5 (pesë) anëtar.</p> <p>Pjesëmarrës janë nga të paktën një përfaqësues nga çdo njësi kryesore (fakultet) me të paktën gradën shkencore "Doktor" i cili nuk ka</p>

<p>ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>angazhime të tjera administrative. Përfaqësohet edhe stafi administrativ me të paktën dy anëtar. Një përfaqësues i studentëve dhe një ekspert i jashtëm (me karrierë publike të mirënjohur në sigurimin e cilësisë). Nënkryetari i Këshillit Studentor për çështje të sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Funksionimi i këtij komisioni bazohet në rregulloren përkatëse. Kjo përbërje garanton përfaqësimin e të gjithë grupeve të interesit në institucion për vlerësimin objektiv të gjetjeve dhe propozimin e përmirësimeve të mundshme.</p> <p>[http://EPOKA.edu.al/mat/aeqi/2019_05_15_Regulation_On_the_Organization_and_Functioning_of_the_PCQA_track_changes.pdf].</p>			
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në vizitën në institucion, dhe në veçanti takimi me Dekanin dhe përfaqësuesin e departamentit, vlerësohet respektimi i fushave të ekspertizës për secilin prej anëtareve të stafit akademik dhe administrativ. Në proceset sqaruese/udhëzuese dhe të vlerësimit të brendshëm merret gjithmonë opinioni dhe vlerësimi i stafit më me eksperiencë apo përgatitje në fushën përkatëse pa diskriminime të pozicionit administrativ që ka në institucion.</p> <p>Gjithashtu, në hartimin e raporteve apo edhe në interpretimin e të dhënave institucionit bazohet në politikat e sigurimit të cilësisë [<i>Annex 25. Quality Policy</i>].</p>			
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) ka në përbërjen e tij një anëtar i cili nuk është staf i Universitetit Epooka. Gjithashtu, pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe përmirësimit të brendshëm, është edhe pjesa e anketimeve alumni [<i>Annex 38. Alumni Survey</i>] dhe rezultateve të përmbledhura të publikuara në faqen ueb të institucionit [http://cpao.EPOKA.edu.al/].</p> <p>Gjatë takimit në institucion, në veçanti takimi me stafin akademik, vihet re një frymë bashkëpunimi edhe me stafin akademik të ftuar në lidhje me procesin e përmirësimit të programeve të studimit dhe të silabuseve të lëndëve. Në veçanti pozitive u vlerësua edhe ndërhyrja në lidhje virtuale (online) me Prof. Arben Asllani (Fullbright me Universitetin EPOKA) [dok. Shënime nga vizita në institucion].</p> <p>Universiteti EPOKA ka marrë pjesë edhe në një projekt Erasmus+ për rritjen e kapaciteteve në IAL ku stafi i Departamentit të Inxhinierisë Kompjuterike ka marrë pjesë aktive në trajnime edhe jashtë Shqipërisë [<i>Dok. RVB</i>].</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në faqen zyrtare në ueb publikohen raporte të përmbledhura për programet e studimit të cilat evidentojnë kryesisht pikat e forta të institucionit [http://aeqi.epoka.edu.al/home.html]</p> <p>Të dhëna të detajuara u ofrohen studentëve gjatë nënshkrimit të kontratës kur regjistrohen si studentë në një program studimi ku një kopje e këtij informacioni rruhet edhe në dosjen e studentit në sekretarinë mësimore [<i>dok. Shënime nga vizita në institucion</i>]. Në këtë fazë studenti njihet me dokumentin e performancës së institucionit dhe në veçanti për programin e studimit të përzgjedhur.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të pyetësorëve të organizuar si në nivel institucioni, ashtu edhe për program studimi jepen në formë të përmbledhur. Të dhënat jepen në formë anonime dhe statistikore në përputhje të plotë me dispozitat e Ligjit Nr. 9887, datë 10 Mars 2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. [http://EPOKA.edu.al/mat/Alumni Survey 2017 BAF.pdf].</p> <p>Të përmbledhur jepen edhe të dhëna tërësore si për programe studimi ashtu edhe për institucionin të publikuara në faqen ueb zyrtare [http://aeqi.EPOKA.edu.al/].</p> <p>Të dhënat e aksesueshme nga stafi në kuadër të raporteve apo anketimeve në lidhje me cilësinë e brendshme apo raporte specifike mbi vlerësimin e stafit janë konfidenciale në qasjen e plotë ndërsa të përpunuara bëhen publike brenda institucionit.</p> <p>Stafi i Universitetit EPOKA ka qasje në të dhënat e raporteve, anketimeve dhe vendimeve të lidhura me to në varësi të funksionit dhe hierarkisë që ka në institucion. Kjo garantohet nga privilegjet gjë gjithsecili ka në sistemin elektronik të menaxhimit të brendshëm i cili garanton privatësinë dhe etikën e qasjes në të dhëna personale apo të përpunuara në nivel institucioni.</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC) dhe organe vartëse si Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Komisioni i Zhvillimit të Kurrikulave dhe Bordi i Provimeve hartojnë raporte në funksion të vlerësimit dhe përmirësimit të cilësisë si për program studimi ashtu edhe në tërësi në nivel institucioni.</p> <p>Bazuar në vlerësimet e raporteve të mësipërme, organet vendimmarrëse kolegjiale në Universitetin EPOKA hartojnë plane të detajuara veprimi për përmirësimin e dobësive të evidentuara. Plane të cilat dorëzohen për miratim në Rektoratin e Universitetit EPOKA, dhe nëse është e nevojshme kërkohet edhe mbështetja nga njësi të tjera të universitetit për zbatimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti EPOKA ka organizuar trajnime informuese dhe ndërgjegjësuese për stafin dhe studentët në rolin e tyre aktiv në sigurimin e cilësisë.</p> <p>Zyra e vlerësimit të brendshëm të cilësisë e cila ka në fokusin e saj vlerësimin dhe sugjerimet për përmirësimin e cilësisë së përgjithshme të institucionit dhe në veçanti për programet e studimit, ka në përbërjen e saj</p>

	një staf të konsoliduar prej vitesh [tab. 24, RVB, Të dhënat për anëtarët e NJSBC]. Prania e një stafi të konsoliduar është tregues i një vazhdimësie të politikave institucionale në kuadër të përmirësimit të cilësisë.			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Universiteti EPOKA përfshin të gjitha organet e brendshme në trajnime periodike jo vetëm për sigurimin e drejtpërdrejtë të cilësisë por edhe në rritjen e kapaciteteve njerëzore çka reflektohet më pas në rritjen e cilësisë në tërësi të aktiviteteve të ofruara nga institucioni. [http://aeqi.epoka.edu.al/cat-training-activities-1411.html].			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Kompjuterike” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti EPOKA”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Zhvillimi i të gjithë aktivitetit (100%) në gjuhën angleze;
2. Cilësia e kurrikulave të ofruara për programin e studimit;
3. Staf akademik me moshë të re dhe me përvojë ndërkombëtare;
4. Procesi i përzgjedhjes për regjistrimin e studentëve dhe ofrimi i bursave me meritë akademike për të tërhequr studentët e suksesshëm;
5. Organizimi i vazhdueshëm i konferencave ndërkombëtare, seminareve dhe aktiviteteve të tjera shkencore;
6. Organizimi i studentëve në grupe/klube për rritjen e jetës sociale përtej asaj akademike;
7. Përdorimi i pajisjeve teknologjike moderne (projektorë, smart board) në procesin e mësimdhënies si dhe kushte të përshtatshme të ambienteve të punës;
8. Abonimi i universitetit në baza të ndryshme të dhënash të bibliotekave elektronike;
9. Marrëdhënie të përshtatshme me institucionet publike dhe sektorin privat për realizimin e praktikave dhe trajnimeve cilësore;
10. Marrëdhënie të institucionalizuara me universitetet e huaja dhe vendase për shkëmbime në rritje të studentëve dhe stafit;
11. Rritje e aplikimeve në projekte ndërkombëtare;
12. Sistem efektiv i menaxhimit elektronik të informacionit i vendosur për aktivitetin e përditshëm didaktik dhe administrativ.

Pika të dobta:

1. Mbështetje e pamjaftueshme nga stafi i IT për t'i bërë projektet laboratorike më fitimprurëse;
2. Jo të gjitha lëndët kanë titullar sipas përcaktimeve ligjore në fuqi;
3. Nevojë e shpeshtë për të përshtatur lëndët e vitit të parë bazuar në ndryshimet e kurrikulave në shkollat e mesme.

Rekomandime:

1. Rritje e peshës së stafit IT dhe laboratorik për zhvillimin e projekteve të zbatueshme dhe fitimprurëse;
2. Të mbulohen të gjitha lëndët e këtij programi studimi me titullar sipas dispozitave ligjore në fuqi;
3. Të tregohet më shumë kujdes në kontrollin e dokumentacioneve që bëhen publike apo vihen në dispozicion për vlerësim jashtë institucionit;
4. Shtimi i lëndëve mbështetëse/plotësuese me zgjedhje për të zbutur apo mbushur boshllëqet e dijeve që studentët kanë nga formimet e tyre në shkollat e mesme.

Conclusions of the evaluation of the first cycle Bachelor study program in “Computer Engineering”, Higher education institution “EPOKA University”**Strengths:**

1. Teaching activity is 100% in english language;
2. Study program with contemporary high quality curricula;
3. Young aged academic staff with international experience;
4. Student enrollment and selection process and scholarship provisioning based on academic merit to attract successful students
5. Continuous organization of international conferences, seminars and complementary scientific activities;
6. Organizing students in groups/clubs to increase social life beyond the academic one;
7. Use of contemporary auxiliary technology infrastructure (projectors, smart board) in teaching process as well as appropriate working environment conditions;
8. University subscription to various electronic library databases;
9. Effective relations with public institutions and the private sector for internships and trainings;

10. Institutionalized relations with foreign and domestic universities for increasing students and staff exchanges;
11. Increase activity for applications in international projects;
12. Effective electronic information management system established for didactic and administrative daily activity.

Weakness:

1. Insufficient support from IT staff to make the project laboratory more suitable;
2. Not all courses have responsible (proprietor) with the required qualification in accordance with applicable legal provisions;
3. Need to adapt first year syllabus subjects based on frequent high schools curriculum changes.

Recommendations:

1. Increasing IT and laboratory staff involvement for development of profitable projects;;
2. Provide all courses with course responsible (proprietor) with the required qualification in accordance with applicable legal provisions;
3. To be more careful in checking the documentation that is made public or made available for evaluation outside the institution;
4. Adding supporting / complementary choice courses to fill or support students knowledge leaks due to high schools curricula.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X